FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.50 | 2 maj | 2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 409 datë 31.3.2011	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ujësjellësi Berat - Kuçovë, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin me grant të projektit "Shërbime konsulence për forcimin e kapaciteteve të ujësjellës – kanalizimeve, Berat-Kuçovë""	2107

LIGJ
Nr.10 409, datë 31.3.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE UJËSJELLËSI BERAT - KUÇOVË, SH.A., SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN ME GRANT TË PROJEKTIT "SHËRBIME KONSULENCE PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE TË UJËSJELLËS – KANALIZIMEVE, BERAT-KUÇOVË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ujësjellësi Berat - Kuçovë, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin me grant të projektit "Shërbime konsulence për forcimin e kapaciteteve të ujësjellës - kanalizimeve, Berat - Kuçovë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6973, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIARE DHE PROJEKTI NDËRMJET KFW-SË, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, MoF (PËRFITUESI) DHE UJËSJELLËSI BERAT-KUÇOVË SHA PËR 770 000 EURO FURNIZIMI ME UJË, PJESA QENDRORE E SHQIPËRISË SHËRBIME KONSULENCE PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE NË UK BERAT KUÇOVË

Në bazë të protokollit të konsultimeve shqiptaro-gjermane mbi bashkëpunimin dhe zhvillimin ekonomik për vitin 2009 (datë 9 dhjetor 2009), përfituesi, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme financiare dhe të projektit.

Neni 1
Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep përfituesit një kontribut financiar që nuk kalon 770 000 euro.

Ky kontribut financiar nuk është i pagueshëm përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Përfituesi e kalon kontributin financiar plotësisht tek agjencia e zbatimit të projektit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit e përdor kontributin

financiar vetëm për shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapacitetit në UK Berat-Kuçova (shërbimet e ekspertëve) dhe kryesisht të paguajë koston e shkëmbimit të huaj. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton hollësitë dhe objektin e shërbimeve të ekspertëve që do të financohen nga kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë, që duhet të miratohet nga Ministria e Financave.

1.3 Përfituesi dhe KfW-ja përcakton me hollësi kontributet përkatëse që duhet të sigurohen nga përfituesi në një marrëveshje të veçantë. Përfituesi i ofron kontributet e tij përkatëse të plota dhe në kohën e duhur. Përfituesi i jep KfW-së me kërkesë prova për masat që janë marrë për këtë qëllim.

1.4 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që mbulohen nga përfituesi ose agjencia e zbatimit të projektit dhe detyrimet mbi importin nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit financiar për agjencinë e zbatimit të projektit

2.1 Përfituesi e kanalizon kontributin financiar tek agjencia e zbatimit të projektit si një grand i pashlyeshëm në bazë të një marrëveshjeje të veçantë financiare.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, përfituesi i paraqet KfW-së një kopje të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit financiar nuk përbën asnjë detyrim për agjencinë e zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesave në bazë të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson kontributin financiar në pajtim me progresin e shërbimeve të ekspertizës dhe me kërkesën e agjencisë së zbatimit të projektit. Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, dhe veçanërisht provat që provojnë që fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimet e parashikuara.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë bërjen e disbursimeve pas 31 dhjetorit 2012.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet përveç kur:

a) Përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij kundrejt KfW-së për bërjen e pagesave kur bëhen të kërkueshme;

b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose të marrëveshjeve të veçanta në pajtim me këtë marrëveshje;

c) Agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që kontributi financiar nuk është përdorur për qëllimin e parashikuar; ose

d) Dalin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e shërbimeve të ekspertizës.

4.2 Nëse një nga situatat e parashikuara në nenin 4.1 b) ose c) ka ndodhur ose nuk është mënjanuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, sidoqoftë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund:

a) Në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 b), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) Në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave që agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 5
Kostoja dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shkaktohen në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6
Deklarimet kontraktuale dhe tagri i përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona të tjerë që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Përfituesin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Drejtori i përgjithshëm i agjencisë së zbatimit të projektit dhe ata persona të tjerë që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Tagri i përfaqësimit nuk skadon para se KfW-ja të marrë revokimin përkatës nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe njoftimet dhe deklarimet e dhëna nga palët kontraktuese në bazë të kësaj marrëveshjeje bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklarim i tillë konsiderohet i marrë nëse ai mbërrin në adresën e mëposhtme të palës përkatëse kontraktuese ose në një adresë tjetër që pala përkatëse kontraktuese i ka njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt mbi Main Federal Republic of Germany Fax. +49 69 7431 – 2944
Për përfituesin:	Ministria e Financave Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 1 Tirana Shqipëri Fax. +355 42 228494
Për agjencinë e zbatimit të projektit:	Ujësjellësi Berat-Kucovë sh.a. Lagja: "13 Shtatori" Berat Shqipëri Fax. +355 32 2 32 947

6.3 Ndryshimet në këtë marrëveshje që ndikojnë vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe përfituesit nuk kërkojnë pëlqimin e agjencisë së zbatimit të projektit.

Neni 7
Shërbimet e ekspertizës

7.1 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) Përgatit dhe zbaton shërbimet e ekspertizës në pajtim me praktikat e shëndosha financiare dhe inxhinierike dhe thellësisht në pajtim me konceptin e rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit

të projektit dhe KfW-së për shërbimet e ekspertizës. Me qëllim që të përgatitë dhe ofrojë shërbimet e ekspertizës, agjencia e zbatimit të projektit përdor shërbimet e ekspertëve konsulentë të pavarur dhe të kualifikuar (konsulenti i trajnimit);

b) Mban ose merr masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartësisht të gjitha shpenzimet e bëra në lidhje me shërbimet e ekspertizës dhe që identifikon qartësisht shërbimet e financuara nga kontributi financiar;

c) U jep mundësi përfaqësuesve të KfW-së të inspektojë në çdo kohë këta libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentet në lidhje me zbatimin e shërbimeve të ekspertizës; dhe

d) I jep KfW-së të gjithë atë informacion dhe raporte për shërbimet e ekspertizës dhe mbi përparimin e tyre të mëtejshëm që mund të kërkojë KfW-ja.

7.2 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit

a) Siguron financim të plotë të shërbimeve të ekspertizës dhe i jep KfW-së me kërkesë prova që provojnë që të gjithë shpenzimet që nuk mbulohen nga kontributi financiar janë paguar; dhe

b) Me iniciativë të vet informon KfW-në për çdo rrethanë dhe pengon ose rrezikon seriozisht zbatimin e shërbimeve të ekspertizës ose qëllimin e tyre.

7.3 Përfituesi ndihmon agjencinë e zbatimit të projektit në pajtim me praktikat e shëndosha financiare dhe inxhinierike në përgatitjen dhe kryerjen e shërbimeve të ekspertizës dhe në përmbushje të detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit në pajtim me këtë marrëveshje dhe, veçanërisht, i jep agjencisë së zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për përgatitjen dhe kryerjen e shërbimeve të ekspertizës.

7.4 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton hollësitë që i përkasin nenit 7.1 në një marrëveshje të veçantë që miratohet nga Ministria e Financave.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit siguron që të paguhen personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e shërbimeve të ekspertizës dhe dhënia e çdo kontrate për shërbimet e ekspertizës si dhe që në lidhje me kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar të mos kërkojnë, përftojnë, japin, sigurojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Nëse një nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që mbetet nga kjo mbushet nga një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.3 Nëse një nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që mbetet nga kjo mbushet nga një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes është Frankfurti am Main.

8.5 Marrëdhëniet ligjore të vendosura ndërmjet kësaj marrëveshjeje ndërmjet KfW-së, përfituesit dhe agjencisë së zbatimit të projektit përfundojnë me mbarimin e kohës së dobishme të shërbimeve të ekspertizës, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

8.6 Kjo marrëveshje hyn në fuqi me përfundimin e procedurave të brendshme ligjore nga përfituesi. Përfituesi informon KfW-në menjëherë pasi të ndodhë kjo.

Bërë në tre kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main	Tiranë
Më: _____ 2010	Më: _____ 2010
KfW	Ministria e Financave
	Berat
	Ujësjellësi Berat – Kuçovë sh.a.

Ujësjellësi Berat – Kuçovë sh.a.
Z. Fatmir Shehu
Lagja 13 shtatori
Berat
Shqipëri

Eva Schneider
Tona: SEv
Tel. +49 69 7431 3648
Fax. +49 69 7431 3490
e-mail: eva.schneider@KfW.de
Datë: 20/07/2010

L III/a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapaciteteve në UK Berat Kuçovë, 0.77 milionë euro
Nr. 193004652 (referuar BMZ-nr. 2000 65 557)
Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e financimit dhe projektit datë _____

Të dashur zotërinj,

Në pajtim me marrëveshjen e financimit dhe projektit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (përfituesi), Ujësjellësi Berat-Kuçovë sh.a. (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW-së (KfW) datë _____, sa më poshtë do të përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2 dhe 1.3

Hollësitë e projektit, si dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar;

Në pajtim me nenin 3.1:

Procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë që shumat e kontributit financiar të disbursuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

Në pajtim me nenin 7.4

Hollësitë në pajtim me nenin 7.1 (zbatimi i projektit)

Ne propozojmë që të bihet dakord sa më poshtë:

I. Hartimi i projektit

1. Hollësitë e projektit

Projekti ka të bëjë me shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapaciteteve në UK Berat Kuçovë (shërbimet e ekspertizës). Qëllimi i projektit është furnizimi i vazhdueshëm dhe efikas me ujë të mjaftueshëm të pijshëm dhe të pastër për popullatën që banon në zonën e furnizimit dhe të mbështesë NUKBK-në në arritjen e mbulimit të kostos dhe të bëhet një shoqëri moderne uji. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës të popullatës në zonën e furnizimit. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit, si dhe prezumimet që mbështesin qëllimin e projektit dhe rezultatet e projektit gjenden në aneksin 1 (kushtet e tenderit dhe termat e referencës së shërbimeve të konsulencës).

Hartimi i projektit është i bazuar në raportin "Identifikimi i masave të fuqizimit institucional (A&F) në Berat dhe Kuçovë (Shqipëri)", të muajit qershor 2009, që i janë dhënë KfW-së, përfituesit dhe agjencisë së zbatimit të projektit. Objektivat, kriteret e performancës, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit që do të financohen nga kontributi financiar janë të përshkruara me hollësi në aneksin 1.

Aktivitetet e projektit synojnë të arrijnë qëllimin e sipër-përmendur të projektit dhe që konsistojnë kryesisht në aktivitetet e trajnimit për personelin e shoqërisë së ujit dhe kanalizimeve të Beratit dhe Kuçovës (Ujësjellësi Berat – Kuçovë sh.a.).

2. Grafiku kohor

Projekti është planifikuar për një periudhë prej 24-muajsh.

3. Kostoja e përgjithshme dhe financimi

Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit (kostoja e përgjithshme) që mbështet vlerësimin e projektit është afërisht 0.77 milionë euro. Shuma e kontributit financiar është deri në 0.77 milionë euro. Nuk është parashikuar një kontribut financiar nga pala tjetër.

Programet dhe pajisjet që duhet të blihen nga konsulenti i trajnimit përdoret ekskluzivisht për qëllime trajnimi, dhe me mbarimin e kësaj marrëveshjeje bëhen pronë e agjencisë së zbatimit të projektit.

4. Ndryshimet në hartimin e projektit

Çdo ndryshim madhor në hartimin e projektit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së. Agjencia e zbatimit të projektit informon KfW-në për këtë menjëherë, duke deklaruar arsyet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë për koston e përgjithshme). Ekzekutimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

II. Zbatimi i projektit

1. Përgjegjësitë dhe afati, kostoja dhe grafiku i financimit

1.1 Agjencia e zbatimit të projektit është përgjegjëse për zbatimin e projektit.

1.2 Afati, kostoja dhe grafiku i detajuar i financimit, të përditësuara rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të projektit, përcaktohet në kontratën e konsulencës (shërbimet e konsulencës për masat e trajnimit) tek ujësjellësi Berat-Kuçovë sh.a. që do të nënshkruhet nga agjencia e zbatimit të projektit dhe konsulenti i trajnimit dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik tregon, me afate dhe personel, ndërlidhjen kronologjike të parashikuar për aktivitetet e projektit dhe kërkesat financiare përkatëse. Nëse një shmangie nga këto grafikë bëhet e nevojshme gjatë zbatimit të projektit, KfW-së i jepet një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i konsulentit

2.1 Detyrat e konsulentit të trajnimit janë përcaktuar në termat e referencës (aneksi 1).

2.2 Pas parazgjedhjes dhe ofertimit konkurrues publik ndërkombëtar, kontrata i jepet një konsulenti të pavarur dhe të kualifikuar. Procedura e dhënies së kontratës rregullohet nga "Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 2), që përbën pjesë integrale të kësaj.

2.3 Procesi i parakualifikimit është finalizuar në pajtim me këto udhëzime. Në njoftimin e parakualifikimit agjencia e zbatimit të projektit ka detyruar ofertuesit që së bashku me dokumentet e ofertimit të paraqesin një deklaratë të nënshkruar rregullisht të sipërmarrjes (aneksi 4, faqe 16).

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për mallrat dhe shërbimet e tjera jepen në bashkëpunim me konsulentin e trajnimit me anë të ofertimit konkurrues ndërkombëtar ose kombëtar. Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për komente në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender, nëse vlera e një furnizimi të veçanti ose shërbimi tjetër të tenderuar vlerësohet nga konsulenti i trajnimit të jetë më shumë se 40 000.00 euro. Afati i ofertimit përcaktohet në një mënyrë të tillë që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.2 Hollësi të mëtejshme në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale shpjegohen në "Udhëzimet për prokurimin e furnizimeve dhe kontratat e punës në bazë të bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 3), që përbën një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

3.3 Në njoftimin e parakualifikimit ose – nëse nuk zhvillohet parakualifikim – në dokumentet e tenderit, agjencia e zbatimit të projektit i detyron ofertuesit që së bashku me dokumentet e ofertimit të paraqesin një deklaratë të nënshkruar rregullisht të sipërmarrjes (aneksi 3, faqe 27).

3.4 Gjatë lidhjes së kontratave për mallra dhe shërbime që financohen nga kontributi financiar, agjencia e zbatimit të projektit respekton edhe parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse detyrimet e importit nuk mund të financohen nga kontributi financiar në pajtim me nenin 1.4 të marrëveshjes së financimit dhe projektit, këto detyrime importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, përcaktohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave për mallrat dhe shërbimet duhet të bëhen nga kontributi financiar, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që parashikon që çdo rimbursim, garanci ose pagesë tjetër e ngjashme e pretendueshme dhe çdo pagesë figuracioni bëhet në llogari të

agjencisë së zbatimit të projektit te llogaria nr. 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) te KfW-ja, Frankfurt am Main (BIC: KFWDEFF; BLZ 500 204 00), dhe KfW-ja krediton këto pagesa në llogarinë e përfituesit. Nëse këto pagesa bëhen ne monedhën vendase, ato kalohen te një llogari e veçantë e agjencisë së zbatimit të projektit në vendin e agjencisë së zbatimit të projektit, që mund të tërhiqen vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.5 Para lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera KfW-së i jepet për komente projekt-kontrata e miratuar, e pajisur rregullisht me pëlqimin e konsulentëve. E njëjta zbatohet për çdo marrëveshje tjetër të mëvonshme modifikuese.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e shërbimeve të ekspertizës që financohet nga kontributi financiar përcaktohet në kushtet e tenderit dhe termat e referencës për shërbimet e konsulencës për masat e trajnimit tek Ujësjellësi Berat-Kuçovë sh.a. (aneksi 1) dhe përfshihet tërësisht në kontratën e konsulentit që duhet të nënshkruhet nga agjencia e zbatimit të projektit dhe konsulenti i trajnimit. KfW-së i jepet një kopje origjinale ose një kopje e kontratës përkatëse për përfshirjen e konsulentit të trajnimit dhe për çdo kontratë përkatëse ndryshuese.

1.2 KfW-ja informon agjencinë e zbatimit të projektit më kërkesë për shumat e kontributit financiar që ai ka rezervuar për financim.

2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas parashikimit në aneksin 4 (procedura e disbursimit), që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të dytë, agjencia e zbatimit të projektit i raporton në çdo semestër KfW-së mbi progresin e projektit (raporte progresi), duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 7.1 d) të marrëveshjes së financimit dhe projektit dhe për zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme të rëndësishme. Përveç kësaj, agjencia e zbatimit të projektit raporton mbi të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimin dhe rezultatet e projektit. Në momentin e përfundimit të projektit, agjencia e zbatimit të projektit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e zbatuara. Përmbajtja e raportit përcaktohet në kontratën e konsulentit që lidhet ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe konsulentit të trajnimit.

2. Dispozita të tjera

2.1 Agjencia e zbatimit të projektit i dërgon KfW-së të gjitha ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në për të dhënë komentet dhe aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkangjitura në kohën e duhur për të dhënë mundësi të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen në çdo kohë m pëlqimin e përbashkët nëse kjo është e nevojshme për zbatimin e projektit ose zbatimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e neneve 6.2 dhe 8 të marrëveshjes së financimit zbatohen përkatësisht për këtë marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e sipër përmendur duke nënshkruar në një formë ligjërisht detyruese dhe duke na kthyer një nga kopjet e bashkëngjitura.

Jeni të lutur të paraqisni një kopje të kësaj letre në kohën e duhur konsulentit të trajnimit, që do të kryejë shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapaciteteve të ujësjellësit Berat-Kuçovë sh.a.

Sinqerisht i juaji

KfW
Frankfurt,
Më _____ 2010

Lexuar dhe rënë dakord
Ujësjellësi Berat – Kuçovë sh.a.

Berat,
Më _____ 2010

Lexuar dhe rënë dakord:
Ministria e Financave
Tirana,
Më _____ 2010

Anekset

Aneksi 1: Kushtet e tenderit dhe termat e referencës për hartimet e konsulencës për masat e trajnimit tek ujësjellësi Berat-Kuçovë sh.a.

Aneksi 2: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 3: Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punës sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 4: Procedura e disbursimit

ANEKSI 1
KUSHTET E TENDERIT DHE TERMAT E REFERENCËS

ANEKSI 2
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

Http://.kfw-entwicklungsbank.de/DE Home/Service und Dokumentacion/Online Bibliothek/PDF-Dokumente Richtlinien/Consultingrichtlinie E 11 200615701.pdf

ANEKSI 3
UDHËZIMET PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNËS SIPAS BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

Http://.kfw-entwicklungsbank.de/DE Home/Service und Dokumentacion/Online Bibliothek/PDF-Dokumente Richtlinien/Vergaberichtlinie E 05 2007.pdf

ANEKSI 4
I MARRËVESHJES SË VEÇANTË

Punonjësi përgjegjës: Caroline Moeller
Tel. +49 69 7431-3542
e-mail: caroline.moeller@KfW.de

PROCEDURA E DISBURSIMIT

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshje huaje/financimi/projekti/programi e KfW-së
0.77 milionë euro
Emri i projektit/programit: Shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapaciteteve në UK Berat-Kuçovë
Nr. i Referencës së KfW-së: 193004652 (në lidhje me numri i referencës së KfW-së: 2000 65 557)

1. HYRJE

Ky aneks parashikon procedurën e disbursimit për projektin/programin e sipër-përmendur. Marrëveshja e veçantë duke përfshirë këtë aneks i ofrohet të gjithë personelit të huamarrësit, përfituesit, ose agjencisë së zbatimit të projektit/programit (pala e autorizuar) dhe çdo pale tjetër që është e përfshirë në disbursimet.

KfW-ja disburson hua dhe kontribute të pakthyeshme (fondet) me kërkesën e palës së autorizuar në pajtim me progresin e projektit/programit të financuar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallra dhe shërbime të caktuara mbi bazën e "Marrëveshjes së veçantë" që i përkasin marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet përkatëse të rezervuara nga kuadri brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja pasi të jenë përmbushur të gjitha parakushtet kontraktuale për disbursimin.

2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

2.1 Të gjitha kërkesat për tërheqje
- tregojnë numrin e referencës të KfW-së;
- janë të numërtuara në mënyrë rendore, dhe
- janë të nënshkruara nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar për KfW-në dhe për të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e nënshkrimeve (shembull: shih shtojcën A).

2.2 Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat origjinale për tërheqjen. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë pas kësaj dhe i shënuar si konfirmim faksi. KfW-ja lirohet nga pala e autorizuar nga përgjegjësia për çdo dëm që rrjedh nga transmetimet e rreme, veçanërisht për shkak të gabimeve në transmetim, abuzimeve, keqkuptimeve ose gabimeve.

2.3 Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga e caktuara (monedha e huaj), KfW-ja debiton huamarrësin ose përfituesin me atë shumë që është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet shtesë.

2.4 KfW-ja nuk është e detyruar për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transferuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse një vonesë shkaktohet nga KfW-ja, detyrimi i saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

3. DISPOZITA TË VEÇANTA

3.1 Pala e autorizuar është ujësjellësi Berat-Kuçovë sh.a.

3.2 Procedura që do të zbatohet

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuara në marrëveshjen e veçanti I.1. + I.3 konsultimi do të disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

3.3 Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqje të nënshkruar rregullisht (shih shtojcën B) duke treguar emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (hollësitë e plota bankare).

3.3.1 Dokumentet që mbështesin kërkesën e tërheqjes, sipas rastit:

- Kopje e faturës së konsulentit;
- Prova për bazën e përcaktuar në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e rritjes së çmimeve;
- Listë e shpenzimeve për koston e rimbursueshme duke treguar datën, përshkrimin, çmimin, kursin e këmbimit për shpenzimet, të nënshkruara rregullisht nga konsulenti që deklaron që informacioni është i vërtetë dhe i saktë.

3.3.2 Dokumentet

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që u përkasin faturave duhet të ruhen të paktën deri në pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të jenë të inspektueshme në çdo kohë nga KfW-ja ose palët e treta që udhëzohen nga KfW-ja (p.sh., auditët) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta që autorizohen nga KfW-ja.

3.4 Njoftimet e debive shpërndahen automatikisht te të adresuarit e marrëveshjes së veçantë dhe palëve të tjera të përfshira që i komunikohen KfW-së nga pala e autorizuar.

Jeni të lutur të kontaktoni punonjësin e KfW-së të përmendur më sipër nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke përmendur numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca

A) Shembull i një letre që cakton nënshkruesit e autorizuar

B) Formular i kërkesës së tërheqjes i procedurës së disbursimit të drejtpërdrejtë, konsulentë

SHTOJCA A
SHEMBULL I NJË LETRE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

Nga: _____

Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit

Në vëmendje të:
KfW Bankengruppe
Attn: L3a4
60046 Frankfurt mbi Main

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshje huaje/financimi/projekti/programi e KfW-së
0.77 milionë euro

Emri i projektit/programit: Shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapaciteteve në UK Berat-Kuçovë

Nr. i referencës së KfW-së: 193004652 (në lidhje me numri i referencës së KfW-së: 2000 65 557)

I/e dashur zonjë/zotëri,

Në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/projektit/programit për projektin/programin e përmendur më sipër, ne do të donim t'ju informonim që një nga personat, ekzemplarët e nënshkrimeve të të cilëve shfaqen në këtë letër është autorizuar të nënshkruajë kërkesat e tërheqjes në emër të huamarrësit/përfituesit/projektit/agjencisë së zbatimit të programit

a) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari i nënshkrimit:

b) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari i nënshkrimit:

c) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari i nënshkrimit:

Të gjitha njoftimet e mëparshme (sipas rastit) që japin nënshkrimet e punonjësve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje në bazë të këtij kontributi huaje/financiar revokohen.

Sinqerisht i juaji

_____

Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar të marrëveshjes së huas/financiare/projektit/programit *Datë*

Shënim. Në rast se çdo kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës, autorizimi duhet ta përcaktojë këtë qartësisht. Nëse nënshkruesit e autorizuar ndahen në dy grupe, dhe kërkohet një nënshkrim i përbashkët, kjo duhet që gjithashtu të përcaktohet qartë.

SHTOJCA B

Nga:

_____ _____

(Adresa e palës së autorizuar) *(datë)*

KfW Bankengruppe
Attn: L3a4
60046 Frankfurt mbi Main
Republika Federale Gjermane

Lënda: TM a - Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshje huaje/financimi/projekti/programi e KfW-së
0.77 milionë euro
Emri i projektit/programit: Shërbimet e konsulencës për zhvillimin e kapaciteteve në UK Berat-Kuçovë
Nr. i referencës së KfW-së: 193004652 (në lidhje me numri i referencës së KfW-së: 2000 65 557)

Kërkesa për tërheqje nr ……
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulent)

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave u janë dhënë juve, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen

Artikulli nr.[1]	Kontrata e konsulencës Datë …… Me ……	Fatura e konsulentit Datë ……. Me ……	Monedha/shuma

Në pajtim me "Listën e mallrave dhe shërbimeve", shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme paguhet nga kontributi i huas/financiar, që ne u kërkojmë të disbursoni si më poshtë:

Monedhë/shumë
……

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)
……

Llogaria nr ……IBAN (sipas rastit)
Emri i bankës: ……Kodi BIC: ……
Banka korrespondente:[2] ……Kodi BIC: ……

……
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

SHQIPËRI
BASHKËPUNIMI FINANCIAR GJERMAN ME REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
FURNIZIMI ME UJË PËR PJESËN QENDRORE TË SHQIPËRISË
KOMPONENTI BERAT – KUÇOVË DHE KOMPONENTI LUSHNJË

DOKUMENT TENDERI
PËR SHËRBIMET E KONSULENCËS PËR MASAT SHOQËRUESE TË TRAJNIMIT PËR NDËRMARRJEN E FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE
BANKA E ZHVILLIMIT KFW – 07.2010

KUSHTET E TENDERIT

1. PROCEDURA E TENDERIT

1.01 Të përgjithshme

Rregullat e këtij tenderi janë në pajtim me versionin e fundit të udhëzimeve të KfW-së për caktimin e konsulentëve për bashkëpunimin financiar. Këto kushte të tenderit përmbajnë kushtet e përgjithshme (kapitulli 1 duke përfshirë 6) dhe kushtet e veçanta të tenderit (SCT) për tenderin e veçantë (kapitulli 7). Kushtet e veçanta të tenderit referohen në tekst nëpërmjet "SCT"-së dhe përmblidhen në kapitullin 7.

1.02 Agjencia e zbatimit të projektit

Agjencia e zbatimit të projektit që më vonë quhet PEA tregohet në SCT.

1.03 Prezantimi i tenderit

Tenderi duhet të paraqitet në një paketë që përmban dy zarfe të veçantë qartësisht të shënuar: një me "propozimin teknik" dhe tjetra me "propozimin financiar". Propozimi financiar vuloset dhe në propozimin teknik nuk gjendet asnjë informacion financiar.

[1] Artikulli i "Listës së mallrave dhe shërbimeve"
[2] Përveç kësaj, nëse banka e personit që i bëhet pagesa nuk gjendet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesat e veçanta kërkohen për çdo monedhë që kërkohet.

Paketa tregon informacionin e mëposhtëm:

- adresën ku duhet të dërgohen ofertat;
- titullin e ftesës për ofertë siç tregohet në letrën e ftesës;
- emrin e ofertuesit;
- fjalët e mëposhtme janë qartësisht të dallueshme: "Ftesë për ofertë, të mos hapet nga shërbimi postar".

1.04 Gjuha e tenderit

Propozimet teknike dhe financiare, si dhe i gjithë komunikimit në lidhje me këtë tender përgatiten në gjuhën e treguar në SCT.

1.05 Paraqitja e ofertave

Ofertat duhet të dërgohen në një (1) origjinal të shënuar qartë dhe të nënshkruar dhe një (1) kopje ose jepet dorazi, duke marrë konfirmimin e marrjes, në adresën e treguar në SCT.

Afati i marrjes së ofertave është i përcaktuar në SCT. Të gjitha ofertat e marra pas këtij afati refuzohen automatikisht pa u vlerësuar.

Një kopje shtesë e ofertave dërgohet për dijeni në adresën dhe në datën e treguar në SCT.

1.06 Afati i vlefshmërisë së ofertave

Përveç kur deklarohet ndryshe në SCT, afati i vlefshmërisë së tenderave i llogaritur nga afati i marrjes së ofertave është 90 ditë.

1.07 Vizita informative në vend dhe mbledhja para ofertave

Ofertuesit ftohen të zhvillojnë një vizitë informative në vendndodhje, me qëllim që të familjarizohen me kushtet lokale që janë të rëndësishme për përmbushjen e shërbimeve të dhëna. Mund të organizohen intervista me PEA-në. Ofertuesit kontaktojnë adresat e treguara në SCT në kohën e duhur para vizitës për të bërë të ditur ardhjen dhe lejuar marrjen e masave të përshtatshme.

Një mbledhje para ofertimit dhe një vizitë e përbashkët informative për të gjithë ofertuesit planifikohen në datat dhe vendet e treguara në SCT.

Kuptohet që të gjitha vizitat informative në vend janë me shpenzimet dhe riskun e vetë ofertuesit.

1.08 Kërkesa për informacion shtesë

Çdo pyetje, komunikim ose kërkesë për informacion shtesë në lidhje me këtë ftesë për ofertë lejohen vetëm me shkrim dhe deri në dy (2) javë para afatit për paraqitjen e propozimeve. Këto kërkesa dërgohen në adresën e treguar në SCT. Nëse është i nevojshëm një sqarim për ftesën për ofertë, përgjigjet do t'u komunikohen me shkrim njëkohësisht të gjithë ofertuesve.

1.09 Ndryshimet në dosjen e tenderit

Ndryshimet në dosjen e tenderit gjatë periudhës së tenderimit nga PEA-ja do t'u komunikohet me shkrim të gjithë ofertuesve të mundshëm të cilëve u janë dhënë dokumentet e tenderit, së bashku me njoftimin për çdo shtyrje të periudhës së tenderit që PEA-ja në marrëveshje me KfW-në mund të konsiderojë të nevojshme për t'u dhënë mundësi ofertuesve të marrin parasysh një ndryshim të tillë.

1.10 Shoqata

Konsulentët/konsorciumet e parazgjedhur mund të formojnë një shoqatë me një konsulent/konsorcium tjetër të parazgjedhur me aprovimin paraprak të PEA-së dhe KfW-së. Çdo ndryshim thelbësor në përbërjen e konsulentit të parazgjedhur ose shoqatën e një partneri shtesë ose të ri duhet të justifikohet nga ofertuesi dhe të aprovohet nga PEA-ja dhe KfW-ja, ndryshe PEA-ja dhe KfW-ja rezervojnë të drejtën të përjashtojnë aplikuesin nga procedura e tenderimit. Ofertuesi e paraqet kërkesën e tij jo më vonë se dy (2) javë para datës së paraqitjes.

1.11 Konsulentët e para-zgjedhur

Një listë e konsulentëve të parazgjedhur jepet në aneksin B të kushteve të tenderit, nëse bëhet parazgjedhje.

2. PËRMBAJTJA E TENDERIT

2.01 Propozimi teknik

Propozimi teknik përmban:

a) Analiza kritike e objektivave të projektit dhe termat e referencës (TOR)

Ofertuesi inkurajohet specifikisht për të paraqitur një analizë të detajuar kritike dhe interpretimin e ofertuesit për objektivat e projektit dhe TOR-in. Kjo mund të përfshijë komente kritike dhe dyshime në lidhje me përshtatshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin e aspekteve të veçanta dhe konceptin si një i tërë, sipas rastit. Metodologjia e sugjeruar duhet të marrë parasysh këto në mënyrë konstruktive.

b) Koncepti dhe metodat e propozuara

Ky seksion do të përfshijë:

- Qëndrimin konceptual dhe metodologjik të propozuar për përmbushjen e shërbimeve. Në këtë kontekst, ofertuesi inkurajohet specifikisht për të mos përsëritur TOR-in, por të tregojë përshtatshmërinë e konceptit të tij në lidhje me TOR-in dhe komentet e tij të bëra për to;

- Një program pune (tabelë) që tregon qartësisht fazat e ndryshme të projektit, si dhe detyrat kryesore të planifikuara, kohëzgjatjen e tyre dhe ndërveprimet. Tabela do të përfshijë gjithashtu pikat kryesore, afatet për diskutime, vendimet dhe paraqitjen e raporteve;

- Grafiku i personelit (tabelë) që tregon qartësisht kohën dhe vendin e caktimit efektiv të çdo profesionisti. Tabela përmbushet ose shoqërohet nga një grafik që tregon afatet e sakta të detyrave për çdo profesionist në vendet e caktimit. Këto afate ndahen për çdo fazë të projektit. Në këtë tabelë detyrat e personelit të jashtëm dhe lokal do të trajtohen veçmas. Ofertuesi inkurajohet të përfshijë personel të ri në ekip në pajtim me udhëzimet e dhëna brenda ekipit të kryesuar nga personeli i lartë dhe zbatimin e tarifave të përshtatshme. Nëse detyra të caktuara nuk përmbushen në vend, ekskluzivisht ofertuesi duhet të përshkruajë se si realizohet ekzekutimi dhe bashkëpunimi ndërmjet personelit në terren dhe në zyrë;

- Një deklaratë për organizimin e punës dhe një organinogramë që tregon organizimin e brendshëm të ofertuesit, si dhe ndërveprimet me PEA-n dhe KfW-në, si dhe me aktorë të tjerë. Përgjegjësitë brenda ekipit të projektit duhet të përkufizohen;

- Shërbimet mbështetëse të parashikuara nga zyrat qendrore për ekipin që punon lokalisht për çështjet administrative dhe teknike që mund të dalin gjatë zbatimit të projektit, si dhe për kontrollin dhe monitorimin e punës;

- Procedurat për menaxhimin e kontrollit të cilësisë së shërbimeve (raportet, dokumentet, skicat), duke përfshirë ato të përgatitura nga partnerët, nënkonsulentët dhe partnerët lokalë, para paraqitjes te PEA dhe KfW-ja. Referenca e thjeshtë tek ISO 9001 nuk konsiderohet të jetë e përshtatshme;

- Logjistika e planifikuar dhe pajisjet për ekzekutimin e shërbimeve.

Ofertuesi ftohet të komentojë për ato zëra të fushave të sipërpërmendura që kërkojnë shpjegime shtesë. Tekstet dhe informacioni duhet të përpilohen dhe prezantohen në mënyrë të tillë që të kenë lidhje me projektin. Ofertuesit nuk duhet të japin shpjegime të gjata në stilin e një dispence. Prezantimi i diagrameve, tabelave dhe grafikëve është i preferuar.

c) Personeli kryesor

nëse ofertuesi është parakualifikuar pas një parakualifikimi, ai këshillohet të formojë ekipin e tij duke përdorur personelin e propozuar në dokumentet e parakualifikimit.

Ofertuesi jep një përshkrim të hollësishëm të detyrave që duhet të përmbushen nga çdo anëtar i ekipit (duke përfshirë personelin mbështetës në zyrat qendrore), si dhe hollësitë për përzgjedhjen dhe eksperiencën e anëtarëve të propozuar në lidhje me detyrat e tyre.

Për më tepër, ofertuesi jep CV-në të përditësuara të personelit të propozuar kryesor ndërkombëtar dhe personelit lokal / rajonal mbështetës për modelin e dhënë në aneksin C-1. Personeli duhet të ketë arsimin, eksperiencën profesionale dhe eksperiencën e nevojshme në rajon. Përveç kur parashikohet ndryshe në SCT, rajoni duhet të përfshijë vendin dhe vendet fqinje me kushte politike, social-ekonomike dhe kulturore të ngjashme. Pritet veçanërisht që personeli kryesor

ndërkombëtar të ketë eksperiencë me projektet, pune dhe profesionale dhe të ketë përmbushur detyra të ngjashme në projekte të ngjashme të një game të ngjashme me financim ndërkombëtar. CV-të duhet të tregojnë nëse anëtari i propozuar i personelit është pjesë e përhershme e personelit të përhershëm të ofertuesit apo jo. Për të mbështetur transparencën dhe për të lehtësuar vlerësimin ofertuesi duhet të përmbledhë të dhënat thelbësore të personelit kryesor të propozuar sipas tabelës në aneksin C-2. Në rastin e paqartësive, mbizotëron CV-ja.

Personeli kryesor i paraqitur në propozimin e ofertuesit nuk mund të zëvendësohet pa aprovimin paraprak të PEA-së dhe KfW-së. Ofertuesi mund të zëvendësojë personelin vetëm me një person me kualifikime të barabarta ose më të mira.

d) Nënkontraktorët

Ofertuesi specifikon qartësisht shërbimet që duhet të kryhen nga nënkontraktorët e ndryshëm nga ata që janë pjesë e shoqatës së konsulencës. Kjo përfshin kryesisht shërbimet shtesë si studimet topografike dhe të tokës, punët e shpimit, testet e pompimit, analizat e kampionëve dhe laboratorike etj. Ai tregon firmat tek të cilat ai synon të nënkontraktojë këto shërbime.

e) Deklarimet

Ofertuesi bën deklarimet e mëposhtme të bëra pas datës së ftesës:

- Deklaratën(at) e bashkimit të nënshkruar nga partnerët dhe që specifikon qartësisht tipin e bashkimit dhe firmën udhëheqëse;

- Deklarimin për firmat e bashkuara: në një deklaratë të nënshkruar rregullisht ofertuesi (në rastin e një bashkimi një deklaratë të veçantë për secilin anëtar) duhet të tregojë lidhjet me firmat e tjera dhe të japë një deklaratë detyruese që nëse i jepet kontrata, firmat me të cilat ai është i bashkuar nuk do të marrin pjesë në projekt në ndonjë formë tjetër;

- Deklarimi i sipërmarrjes: Përfshihet një deklaratë e nënshkruar rregullisht (në rastin e një bashkimi nga të gjithë anëtarët) në pajtim me aneksin D.

2.02 Propozimi financiar

Bazuar në numrin e personelit dhe shërbimeve të tjera, ofertuesi duhet të paraqesë një propozim financiar. Të gjitha tarifat do të jenë në një monedhë të treguar nga SCT-ja. Në rastin e mbikëqyrjes së ndërtimit ose projekteve të trajnimit, ofertuesi cakton një afat kontrate siç tregohet në SCT për qëllimin e një vlerësimi të drejtë dhe krahasimin e kontributit të personelit dhe kostos përkatëse. Për kontributet e PEA-s në lidhje me d)- h) më poshtë, referojuni 4.04 dhe SCT-së. Propozimi financiar përmban informacionin e mëposhtëm dhe strukturohet i detajuar në aneksin E.

Buxheti i plotë i disponueshëm për shërbimet që jepen, tregohet në SCT.

a) Kostoja e personelit për personelin ndërkombëtar dhe lokal/rajonal duke përfshirë tarifën mujore për zyrën qendrore, duke përfshirë pagat, kontributet shoqërore dhe koston shtesë, shpërblimet, lejet dhe raportet shëndetësore, kostoja e zyrës qendrore, të gjitha vizitat mjekësore, trajnimin profesional, shërbimet mbështetëse nga zyra qendrore (me personel, profesionale dhe administrative), koston e pajisjeve të IT-së, sigurimet profesionale të shoqërisë, riskun dhe fitimin.

b) Honorarët dhe akomodimi për të jashtmit (akomodimi në hotel, apartament/shtëpi me dhënien e mobilieve dhe pajisjeve me blerje ose qira) dhe, sipas rastit, për personelin lokal (çdo muaj).

c) Kostoja e udhëtimeve ndërkombëtare përfshin:

- Biletat e fluturimeve ndërkombëtare (bazuar në kategorinë e biznesit), duke përfshirë koston shtesë të udhëtimit (p.sh, kostoja e transfertës për në dhe nga aeroporti, viza, taksa e aeroportit, bagazhi shtesë dhe/ose transporti me rrugë ajrore, shpenzimet mjekësore, viza etj.) si një artikull me shumë totale për një udhëtim vajtje-ardhje.

- Biletat e avionit për qëllime inspektimi, sipas rastit.

d) Kostoja për transport lokal përfshin

- Marrjen me qira të automjeteve të projektit ose koston e amortizimit të mjeteve që janë në pronësi të ofertuesit si një shumë e plotë për muaj për një artikull të tillë (për blerjen e mjeteve me buxhetin e projektit dhe procedurat përkatëse i përkasin pikës (g) më poshtë);

- Shpenzimet e përdorimit të automjeteve të marra me qira si një shumë mujore për automjet, duke përfshirë karburantin, vajin, gomat dhe mjetet e tjera të konsumit, sigurimin, mirëmbajtjen dhe koston e riparimit, si dhe koston për shoferin. Përdorimi privat i automjeteve zyrtare jashtë kohës së punës (nëse lejohet) duhet të specifikohet në propozimin financiar dhe duhet të bëhet një zbritje prej 20% në koston operative;

- Kostoja për udhëtimet lokale, ajrore, rrugore dhe hekurudhore, sipas rastit, në një shumë të plotë për artikull;

- Kostoja e taksisë për transportin lokal në kohën e pikut.

e) Kostoja për zyrën lokale të projektit ofrohet si një shumë e plotë mujore që përbëhet nga:

- Qiraja e zyrës;

- Kostoja e operimit ë zyrës (duke përfshirë pastrimin, energjinë elektrike, ujin, ngrohjen, ajrin e kondicionuar, sigurimin, telekomunikacionin, transportet ndërkombëtare dhe lokale etj., dhe të gjitha sendet e konsumit në zyra).

f) Përgatitja e raporteve, për këtë ofrohet si një shumë e plotë për kopje të një raporti specifik që mbulon shpenzimet për përgatitjen e raportit (duke përfshirë shpërndarjen lokale dhe të mallrave) siç specifikohet në TOR dhe në propozimin teknik. Kostoja për fotografitë e progresit, nëse merren specifikisht dhe përdoren për projektet apo jo, përfshihen në shumën e plotë si artikull.

g) Prokurimi i pajisjeve: Propozimi financiar përfshin prokurimin e të gjitha pajisjeve të zyrës dhe punës si automjetet (të ndryshme nga ato që janë marrë me qira ose në pronësi të ofertuesit), mobiliet, pajisjet, instrumentet për studimet, matjet dhe testimin etj., që ofertuesi e konsideron të nevojshme për ekzekutimin e projektit dhe që, pas përfundimit të shërbimeve të tij, do t'i jepen PEA-s, duke marrë parasysh amortizimin sipas kushteve operative të projektit. Kostoja përkatëse do të rimbursohet me paraqitjen e provave shkresore në monedhën ose siç janë bërë gjatë projektit në monedhën e projektit me kursin e këmbimit të datës së faturës. Nuk pranohen tarifa përpunimi.

Shënim. Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve për zbatimin e projektit nëpërmjet një fondi disponimi ose tjetër duhet të menaxhohet dhe kontrollohet nëpërmjet përfshirjes së një personeli të kualifikuar dhe të përshtatshëm në ekip.

h) Kostoja e ndryshme përfshin të gjitha shpenzimet që nuk mund të mbulohen nga kategoritë e mëposhtme. Këto kosto duhet të shprehen në artikuj me shumë të plotë (e preferuar), ndryshe ato do të rimbursohen në monedhën e bërë me paraqitjen e provave shkresore. Shembujt e mëposhtëm mund të përfshihen në kosto të ndryshme:

- shërbime shtesë në pajtim me nenin 2.01-d;
- blerja e hartave të qytetit, fotografive ajrore, imazheve satelitore;
- marrja me qira e pajisjeve të projektit (p.sh., studimet gjeofizike);
- studimet topografike dhe të tokës për vendet dhe shtrirjen e tubacioneve;
- kostoja e inspektimit të punës/fabrikës;
- vizitat studimore për personelin homolog;
- përgatitja dhe menaxhimi i seminareve dhe trajnimeve;
- masat trajnuese nëpërmjet palëve të treta;
- shuma të tjera të buxhetit/provizore për artikuj të ndryshëm, shërbime ose shpenzime të tjera që tregohen në modelin e deklarimit të shpenzimeve – sipas rastit.

Nëse nuk parashikohet ndryshe në SCT, asnjë artikull tjetër përveç atyre të deklaruara më sipër nuk pranohet në propozimin financiar dhe nuk konsiderohen për pagesë. Nëse ofertuesi mendon se një komponent shumë i rëndësishëm i kostos nuk është mbuluar nga udhëzimi i mësipërm, ai mund të kërkojë leje për të përfshirë këtë artikull. Një kërkesë e tillë duhet të paraqitet në PEA dhe KfW jo më vonë se tre javë para datës së paraqitjes. Rezultati do t'i komunikohet si një qarkore të gjithë ofertuesve.

Përveç kur parashikohet ndryshe në SCT, asnjë takse nuk duhet të përfshihet në propozimin financiar.

3 KUSHTET E PAGESËS

3.01 Monedha

Të gjitha pagesat do të bëhen në monedhën (monedhat) e treguara në SCT.

3.02 Tatimet dhe detyrimet

Ofertuesi përgatit ofertën e tij duke prezumuar që ai dhe personeli i tij i huaj përjashtohet nga tatimet, detyrimet, tarifat dhe pagesa të tjera sipas parashikimit në Kontratën Standarde për Konsultën të KfW-së.

3.03 Përshtatja e çmimeve

Nëse nuk tregohet ndryshe në SCT, të gjitha tarifat për njësi dhe totale të paraqitura në propozimin financiar, me përjashtim të artikujve të rimbursueshëm, konsiderohen si fikse për një periudhë prej dy (2) vjetësh nga fundi i periudhës së vlefshmërisë. Për shërbimet tej asaj date, përshtatja e çmimeve do të pranohet duke zbatuar formulën e mëposhtme për përshtatje:

Pn – Po* (0.15 + 0.85* In/Io)

Pn = çmimi i ri i rishikuar

Po = çmimi fillestar

In = indeksi i ri i muajit të shërbimeve përkatëse që jepen

Io = indeksi fillestar i muajit kur mbaron vlefshmëria

Rregullimi i çmimit do të llogaritet duke përdorur indeksin e parashikuar në SCT.

3.04 Kushtet e Pagesës

Ofertuesi supozon që për përgatitjen e Propozimit Financiar pagesat do të bëhen sipas radhës së mëposhtme:

Parapagesa: Pas nënshkrimit të kontratës Konsulenti mund të pretendojë një pagesë paraprake sipas parashikimit në SCT. Nëse pagesa paraprake kalon 150 000 Euro, kërkohet një garanci për pagesën paraprake për shumën që është tej 150 000 euro sipas modelit të bashkëngjitur (aneksi F). Parapagesa duhet të rimbursohet gjatë 2/3 të periudhës së përfundimit. Për rrjedhojë, garancia mund të ulet.

Pagesat e ndërmjetme: Konsulenti ka të drejtën të marrë pagesë të ndërmjetme për periudhat ndërmjet tre dhe gjashtë muajve siç është rënë dakord gjatë negociimit të kontratës, duke marrë parasysh rimbursimin për pagesën paraprake dhe paratë e mbajtura, sipas rastit.

Pagesa përfundimtare: Balanca sipas parashikimit në SCT pas pranimit të raportit përfundimtar nga PEA dhe KfW-ja dhe paraqitjes së faturës përfundimtare.

Nëse ofertuesi kërkon ndryshime në grafikun e disbursimit, ai duhet të justifikojë një kërkesë të tillë në propozimin e tij. Ai mund të bëjë propozime të përshtatshme dhe të justifikuara për konvertimin e artikujve të rimbursueshëm në shuma totale bazuar në norma fikse. Procedurat e pagesës përfundimtare do të përcaktohen gjatë negociatave të kontratës.

Të gjitha faturat për pagesat e përkohshme dhe përfundimtare duke përfshirë raportin përkatës, duhet të aprovohen nga PEA.

3.05 Garancitë

Nëse nuk është parashikuar ndryshe në SCT, nuk kërkohet asnjë garanci oferte dhe as garanci përmbushjeje detyrimi.

4. ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE

4.01 Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e projektit nga fillimi i shërbimeve deri në prezantimin e projekt-raportit përfundimtar tregohet në SCT. Periudhat e aprovimit për rishikim dhe komentet e PEA-s dhe KfW-së tregohen në SCT. Këto janë përfshirë në periudhën e përfundimit të projektit.

4.02 Shërbimet e kërkuara

Shërbimet duhet të përmbushin në të gjitha aspektet kërkesat e parashikuara në termat e referencës (TOR) të dhëna në aneksin A që do të jenë pjesë e kontratës së konsulencës. Përgatitja e propozimit të ofertuesit përfshin një verifikim kritik të këtyre shërbimeve dhe, sipas rastit, përmbushjen dhe modifikimin e tyre në pajtim me vlerësimin e vetë ofertuesit të situatës lokale dhe eksperiencës profesionale me qëllim që të arrihen objektivat e caktuara të projektit. Në këtë

kontekst, do të respektohen standardet dhe ligjet lokale.

4.03 Përmbushja e shërbimeve

Konsulenti bashkërendon të gjitha aktivitetet e tij me koordinatorin e projektit të caktuar nga PEA-ja. Të gjitha komunikimet zyrtare drejtuar PEA-s në lidhje me projektin duhet t'i drejtohen njëkohësisht KfW-së.

Nëse nuk është parashikuar ndryshe në SCT, konsulenti do t'i ofrojë shërbimet e tij në vendin e projektit. Ai do të integrojë personelin e PEA-s në masën që është e mundur në punën e tij të përditshme, me qëllim që të sigurojë një transferim maksimal të ekspertizës. Në rast se shërbimet duhet të përmbushen jashtë vendit të projektit, ofertuesi duhet të paraqesë propozime të hollësishme në ofertën e tij teknike.

4.04 Kontributi i PEA-s

Ofertuesi do të marrë parasysh në propozimin e tij financiar që PEA:

- do të ofrojë ofertuesit të gjithë informacionin, dokumentet, hartat, fotografitë ajrore etj., në zotërim të tij dhe të nevojshme për përmbushjen e shërbimeve, pa pagesë, gjatë kohëzgjatjes së projektit;
- do të sigurojë që ofertuesi të ketë të gjitha lejet e nevojshme për të marrë dokumentet, hartat dhe fotografitë e mëtejshme;
- do të mbështesë ofertuesin në marrjen e të gjitha lejeve të nevojshme të punës, lejeve të qëndrimit dhe licencave të importit;
- do të japë kontribute të tjera sipas parashikimit në SCT.

5. VLERËSIMI I TENDERIT

5.01 Të përgjithshme

Përzgjedhja e firmës së konsulencës për ekzekutimin e shërbimeve do të bëhet në pajtim me versionin e fundit të "Udhëzimeve për caktimin e konsulentëve" të KfW-së. Versioni i fundit mund të shkarkohet nga faqja e internetit të KfW-së www.kfw.de.

5.02 Propozimi teknik

Vetëm propozimet teknike do të hapen në datën e paraqitjes. Propozimet financiare mbeten të nënshkruara deri sa të përfundohet vlerësimi teknik.

Cilësia e çdo propozimi teknik do të vlerësohet me shkallën nga 0 deri 100 pikë, sipas kritereve që jepen në SCT, që do të shqyrtohen në pajtim me kërkesat e treguara në termat e referencës.

Nëse ka mospërmbushje të vogla në lidhje me TOR-in, pikët zbriten. Mospërmbushjet që kufizojnë krahasimin me ofertuesit e tjerë mund të çojnë në përjashtimin e kandidatit. Ofertuesit gjithashtu nuk konsiderohen nëse nuk janë paraqitur deklaratat sipas kërkesave të nenit 2.01.

5.03 Propozimi financiar

Pas vlerësimit të propozimit teknik, do të hapen propozimet financiare të atyre ofertuesve, propozimet teknike të të cilëve kanë arritur një minimum pikësh prej 75.

Pas korrigjimit të ndonjë gabimi aritmetik, vlerësimi i kuotimeve të çmimeve do të bëhet me ose pa shpenzime të rimbursueshme dhe të ndryshme. Çdo artikull që mungon në ofertat individuale do të shtohet. Kjo do të bëhet mbi bazën e çmimit më të lartë për njësi për të gjithë ofertuesit.

Nëse pranohen monedha të huaja ose lokale (shih SCT), kostoja lokale do të konvertohet në euro sipas kursit të këmbimit të datës së paraqitjes dhe kostoja totale do të përdoret për vlerësimin financiar.

5.04 Vlerësimi përfundimtar

Për qëllimin e një vlerësimi të kombinuar, propozimi teknik i një ofertuesi do të ponderohet me 80% si më poshtë:

$P_T = 80*T/To$, me

P_T = pikë të dhëna për propozimin teknik,

T = Pikët e ofertuesit në vlerësimin teknik

To – pikat më të larta "teknike" të të gjithë ofertuesve.

Propozimi financiar i një tenderuesi do të ponderohet me 20% si më poshtë:

$P_F = 20^* Co/C$, me

P_F – pikët e dhëna për propozimin financiar (pikët),

C = çmimi i korrigjuar i ofertuesit për propozimin financiar,

Co = Propozimi më i ulët i korrigjuar financiar.

Pikët e plota të tenderit

$P = P_F + P_T$.

Në përgjithësi, vlerësimi i kombinuar do të bëhet pa kosto të rimbursueshme dhe të ndryshme.

Ofertuesi që ka paraqitur propozimin me pikët më të larta të plota do të ftohet për të negociuar kontratën. Bisedimet do të mbulojnë propozimin teknik dhe alternativat e pranueshme të zbatimit ose modelin e personelit dhe pagesave, por jo normat e njësive dhe çmimet që janë marrë parasysh në vlerësimin e kuotimit të çmimit. Nëse bisedimet me ofertuesin që ka marrë pikët më të larta nuk janë të suksesshme, fillojnë bisedimet me ofertuesin pas tij derisa të arrihet një marrëveshje.

5.05 Kontrata e konsulencës

Propozimet teknike dhe financiare të ofertuesit të suksesshëm do të bëhen pjesë e kontratës që do të lidhet. PEA dhe KfW-ja rezervojnë të drejtën të negociojnë dhe të përshtatin ato pjesë të propozimit të ofertuesit, që konsiderohen të papërshtatshme me kërkesat e punës. Tarifat dhe normat e njësive që janë marrë parasysh në vlerësimin e kuotimit të çmimit, në parim, nuk i nënshtrohen negocimit.

Ofertuesi i suksesshëm do të përgatisë një projekt-kontratë sipas kontratës standarde që është e disponueshme te www.kfw.de.

Kontrata me ofertuesin e përzgjedhur do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga ofertuesi dhe PEA dhe me hyrjen në fuqi të fondeve të projektit.

6 TË TJERA

6.01 Ofertuesit e pasuksesshëm

Pas vlerësimit të propozimeve teknike, ofertuesit që nuk kanë arritur pikët e kërkuara minimale do të njoftohen me shkrim. Propozimet financiare do të kthehen të pahapura.

Pasi të jetë njoftuar ofertuesi fitues për dhënien e kontratës, ofertuesit e tjerë do të njoftohen me shkrim në lidhje me mospranimin e propozimeve të tyre.

6.02 Anulimi i tenderit

Procedura e tenderit mund të anulohet para dhënies së kontratës, pa shkaktuar asnjë detyrim për ofertuesit, dhe pavarësisht fazës së procedurës që çon drejt lidhjes së kontratës, nëse

- projekti është anuluar;
- rrethanat që mbështesin ftesën për ofertë kanë ndryshuar së tepërmi;
- asnjë ofertues nuk përmbush kriteret për dhënien e kontratës;
- konkurrenca nuk ishte e përshtatshme;
- kushtet për një konkurrencë të drejtë nuk janë zbatuar;
- kuotimet e çmimeve janë të paarsyeshme dhe/ose kalojnë burimet financiare që janë caktuar në kontratë. Në këtë rast, PEA dhe KfW-ja, si alternativë për ritenderim, hyjnë në bisedime me ofertuesin fitues duke u përpjekur të arrihet një ofertë e pranueshme.

Në rastin e anulimit të procedurës së tenderit, ofertuesit njoftohen për këtë nga PEA. Këta ofertues nuk kanë të drejta për kompensim.

6.03 Kushte të tjera

Kushtet ose kufizimet e tjera të tenderit, sipas rastit, tregohen në SCT.

7. KUSHTET E VEÇANTA TË TENDERIT (SCT)

GCT 1.02	Ujësjellës Berat Kuçovë sh.a. për komponentin Berat-Kuçovë dhe Ujësjellës Lushnja sh.a. për komponentin e Lushnjës
GCT 1.04	Gjuha e propozimit dhe e të gjithë komunikimeve është anglishtja, përveç kur përcaktohet ndryshe në letrën e ftesës
GCT 1.05	Propozimi dërgohet në adresën e mëposhtme ose dorëzohet para datës dhe orës së treguar në letrën e ftesës ose në reklamë Ujësjellës Berat Kuçovë sh.a. Z. Fatmir Shehu Lagjja: "13 shtatori" Berat, Shqipëri Një kopje shtesë dërgohet në adresën e mëposhtme ose dorëzohet para datës dhe orës së treguar në letrën e ftesës ose në reklamë KfW Entwicklungsbank Ms Eva Schneider, Department L III a/4 Palmengartenstrasse 5-9 60325 Frankfurt/Main Germany
GCT 1.06	Përveç kur shprehet ndryshe në letrën e ftesës, vlefshmëria e tenderit është 90 ditë
GCT 1.07	Data e një vizite në vend, sipas rastit, dhe adresat e kontaktit tregohen në letrën e ftesës. Data dhe vendi i takimit para ofertues, sipas rastit, dhe adresat e kontaktit tregohen në letrën e ftesës.
GCT 1.08	Kërkesat për informacion shtesë tregohen në adresat e mëposhtme: Agjenti i tenderit: Strasser&Strasser Consulting GmbH Z Joerg Strasser St.-Veiter Strasse 1 9020 Klagenfurt Austria e-mail: is@strasser-strasser.at
GCT 2.01	Vendet rajonale janë: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Bullgaria, Moldavia dhe Rumania
GCT 2.02	Monedha e normave do të jetë në euro Për periudhën e kontratës shihni SCT 4.01 Propozimi financiar duhet të paraqesë informacion të veçantë në lidhje me sasitë dhe shumat për Detyrat që duhet të jepen për Komponentin Berat-Kuçova dhe shërbimet që duhet të jepen për Komponentin Lushnja (shih aneksin E). Buxheti i plotë që ofrohet është i kufizuar në 770, 000 euro për detyrat që duhet të përmbushen për komponentin Berat-Kuçovë dhe një shtesë prej 128,900 eurosh për shërbimet e dhëna për komponentin Lushnja.
GCT 3.01	Monedha e propozimit do të jetë euro.
GCT 3.02	Në propozimin financiar nuk tregohet asnjë tatim.
GCT 3.03	Normat e propozimit caktohen për një periudhë prej tre (3) vitesh. "I" është indeksi i kostos së jetesës në Gjermani sipas publikimit të Zyrës Federale Gjermane për Statistikat (Statistisches Bundesamt)
GCT 3.04	Pagesa paraprake mund të jetë deri në 15% të shumës së plotë të kontratës. Pagesa përfundimtare do të jetë rreth 10% të shumës së kontratës.
GCT 3.05	Nuk kërkohet asnjë garanci tenderi. Nëse pagesa paraprake kalon 150 000 euro, kërkohet një garanci e pagesës paraprake për shumën që kalon 150 000 euro sipas modelit të bashkëngjitur (aneksi F). Nuk kërkohet garanci për përmbushje detyrimi.
GCT 4.01	Kohëzgjatja e projektit nga data e fillimit të shërbimeve është njëzet e katër muaj (24) për komponentin Berat-Kuçova dhe dymbëdhjetë (12) muaj për komponentin Lushnja.
GCT 4.01	Periudha e aprovimit për dokumentet dhe raportet do të jetë katër (4) javë.
GCT 4.03	Shërbimet e konsulencës do të jepen në vendin e projektit.
GCT 4.04	PEA nuk jep shërbime shtesë.
GCT 5.02	Vlerësimi teknik do të bëhet duke përdorur kriteret e mëposhtme dhe pikët maksimale të mëposhtme:

1.	Koncepti dhe metodologjia		40
1.1	Qartësia dhe tërësia e tenderit	10	

	1.2	Analiza kritike e objektivave të projektit dhe TOR-i	10	
	1.3	Konceptet dhe metodat e propozuara	20	
	2.	Kualifikimet e personelit të propozuar		60
	2.1	Drejtuesi i ekipit / menaxheri i projektit	30	
	2.2	Personel tjetër kryesor që punësohet në projekt	20	
	2.3	Personel në zyrën qendrore që do të monitorojë dhe kontrollojë ekipet dhe sigurojë shërbimet mbështetëse	10	
	Totali (maksimumi)			100

ANEKSI A
TERMAT E REFERENCËS (TOR)

ANEKSI A

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë

Masë trajnimi për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimeve Berat-Kuçova dhe Lushnjë (projekti)

Termat e referencës për shërbimet e konsulencës (shërbimet)

Korrik 2010

Ujësjellës Berat-Kuçova sh.a.

Ujësjellës Lushnjë sh.a.

1. Hyrje

1.01 Të përgjithshme

Ujësjellësi i Beratit dhe Kuçovës dhe ujësjellësi i Lushnjës synojnë të angazhojnë një konsulent për të dhënë shërbime konsulence (shërbimet) që duhet të realizojë masën e kërkuar për trajnim. Të dyja ndërmarrjet veprojnë si agjenci të pavarura të zbatimit të projektit (PEA) dhe shërbimet do të jepen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Ndërmarrja e ujit të Beratit dhe Kuçovës "Ujësjellës Berat-Kuçova sh.a. (NUNBK), si agjenci e zbatimit të projektit (PEA), është formuar së fundi nga bashkimi i dy shoqërive të mëparshme të pavarura.

Shërbimet për NUKBK-në përfshijnë masa në lidhje me:

1. Ulja e humbjeve (përqendrimi në humbjet administrative)
2. Përmirësimi i procedurave financiare dhe tregtare;
3. Përmirësimi i organizimit dhe procedurave teknike;
4. Zhvillimi, trajnimi dhe realizimi i të ardhurave dhe programeve për kursimin e kostos për të arritur pavarësinë financiare dhe mbulimin e shpenzimeve;
5. Zhvillimi organizativ

Masa e trajnimit që jepet për shoqërinë e ujit të Lushnjës "Ujësjellës Lushnja sh.a. (NUKL) përbëhet nga:

1. Vlerësimi i situatës së tashme institucionale të NUKL-së;
2. Prezantimi i masave të propozuara, me qëllim që të përmirësohen procedurat financiare, tregtare dhe teknike;
3. Realizimi i trajnimeve në lidhje me masat e propozuara.

Shërbimet e kërkuara për konsulencën jepen nga një konsulent ndërkombëtar ose një konsorcium i konsulentëve ndërkombëtare dhe shqiptarë. Konsulentët duhet të japin prova që ata janë të njohur me zhvillimin organizativ të njësive tregtare, financiare dhe teknike, masat administrative për uljen e humbjeve, prezantimin e faturimit dhe procedurave të llogarive dhe teknike, si dhe IT-në.

Të gjitha shërbimet e përshkruara në termat e referencës (TOR) përmbushen në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë e zbatimit të projektit (PEA). Për më tepër, konsulenti do të

lidhet me të gjitha palët e përfshira në projekt, veçanërisht me përfaqësuesit e bashkive të Beratit dhe Kuçovës dhe përkatësisht me përfaqësuesit e bashkisë së Lushnjës. Me qëllim që të familjarizohen me kuadrin e projektit dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të projektit, Ofertuesit inkurajohen veçanërisht të marrin kontakt me PEA-të.

Është bërë përpjekje për të paraqitur detyrat e konsulentit mbi bazën e informacionit të disponueshëm në mënyrë sa më të detajuar. Megjithatë, konsulenti duhet të mbajë parasysh që lista e detyrave dhe aktiviteteve nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë si e plotë dhe përshkrim i plotë i detyrave të konsulentit. Është më shumë përgjegjësia e ofertuesit për të verifikuar objektin e shërbimeve të treguara dhe për ta zgjeruar, pakësuar ose ndryshuar atë si ta mendojë të nevojshme sipas gjykimit të tij profesional dhe njohurisë që ai do të përftojë gjatë përgatitjes së këtij propozimi. Kuptohet që konsulenti kryen të gjithë punën që është e nevojshme për të përmbushur objektivat e programit.

Ofertuesi pritet të paraqesë një ofertë të plotë që mbulon të gjitha shërbimet e kërkuara për kryerjen e shërbimeve të tij dhe arritjen e objektivave të formuluar. Gjatë detyrës së konsulentit, konsulentë dhe këshilltarë të tjerë mund të japin shërbimet e tyre për PEA-të dhe/ose autoritetet lokale. Është detyra e konsulentit të takohet dhe të bashkërendojë aktivitetet e tij me operacionet e të tjerëve që i përkasin projektit, veçanërisht me konsulentin e zbatimit. Duhet të sigurohet që standardet, sistemet dhe metodat e propozuara të jenë sa më të qëndrueshme që të jetë e mundur për të mënjanuar dublimin e përpjekjeve.

1.02 Të dhëna paraprake për projektin

NUKBK-ja furnizon rreth 95 000 qytetarë me ujë dhe 78 000 qytetarë me shërbimet e kanalizimeve. Masat e emergjencës janë marrë në të shkuarën dhe më 15 mars 2009 një konsulent zbatimi filloi të ofronte shërbimet e konsulencës për "Programin e furnizimit me ujë në pjesën qendrore të Shqipërisë, komponenti Berat dhe Kuçovë". Investimet në vazhdim përbëhen nga masa në:

- rehabilitimin dhe ndërtimin e sistemit të zgjeruar të transmetimit;
- rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të shpërndarjes së ujit, dhe
- lidhja me fshatrat fqinje në linjat kryesore të transmetimit.

Në kuadrin e konsulentit të zbatimit sipas programit në vazhdim, nuk janë përfshirë masat për forcimin institucional për NUK Ujësjellësi Berat Kuçovë sh.a. Këto shërbime përmbushen në një kontratë të veçantë si masë trajnimi.

Objektivi kryesor i masave të zbatimit dhe trajnimit institucional është furnizimi me ujë 24 orë i popullatës që banon në zonat e furnizimit dhe të mbështesë NUKBK-në për realizimin e mbulimit të kostos dhe bërjes së një shoqërie moderne.

Rreth 60 000 banorë banojnë në zonën e furnizimit të NUKL-së, duke përfshirë qytetin e Lushnjës dhe fshatrat rreth e rrotull. Masat e zbatimit ndërmjet viteve 2003 dhe 2010, që përbëhen kryesisht nga shpimi i puseve në zonën e Konjatit, linja e transmetimit kryesor për në Lushnjë, ndërtimi i rezervuarëve dhe instalimi i matësve të ujit nëpër shtëpi janë financuar nga KfW-ja.

Deri në 2007 një masë shoqëruese ka dhënë mbështetje institucionale në fushat e operacioneve teknike, uljen e humbjeve, llogarive, faturimit, raportimit, duke përfshirë prezantimin e EDP-së.

1.03 Njësitë kryesore (NUKBK)

Zona e projektit përfshin qytetet e Beratit dhe Kuçovës, dhe bashkitë rreth e rrotull të Orrlakut, Vertroit, Perondit dhe Kozarës.

Para vitit 2008 operonin dy shoqëri të pavarura për ujin dhe mbulonin zonat e Beratit (duke përfshirë Otlakun dhe Vertropin) dhe Kuçovës (duke përfshirë Perondin dhe Kozarën) dhe furnizonin popullatën me ujë dhe shërbime kanalizimesh.

Të dyja shoqëritë janë bashkuar në maj 2008, ndërsa të dyja qytetet dhe bashkitë janë aksionere të subjektit të ri të përbashkët.

1.04 Zona e furnizimit (NUKBK)

Zonat e furnizimit tashmë nuk janë të lidhura. Është një nga detyrat kryesore të programit në vazhdim (shërbimet e zbatimit) të ndërtojnë një linjë transmetimi dhe të lidhin të dyja zonat.

Zona e furnizimit Berat

Berati (Vertropi dhe Otlaku) furnizohen për 10 muaj në vit vetëm nga burimet e Bugovës 38 km në jug të qytetit. Burimi i një cilësie të shkëlqyer ushqen linjën e transmetimit që mbush rezervuare të ndryshëm, duke furnizuar zonat e qytetit të Beratit. Gjatë kohës së verës pompohet ujë shtesë nga zona e Uznovës.

Disa fshatra të qytetit ushqehen drejtpërdrejt nga linja kryesore. Rrjeti i shpërndarjes në qytetin e Beratit është në një gjendje tepër të keqe dhe për shkak të mungesës së vazhdueshme të fondeve janë bërë vetëm riparimet e emergjencës dhe jo riparime parandaluese.

Shpërndarja e ujit në zona të ndryshme me presion të ndryshëm është një praktikë mjaft sfiduese pasi kontrolluesit e ujit në rezervuarë duhet të monitorohen nga operatorët.

Përveç humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes, humbjet administrative janë tepër të larta, të shkaktuara nga lidhjet e paligjshme të nxitura nga mungesa e matësve (vetëm 14% e konsumatorëve kanë matës). Konsumi i faturuar është vetëm 22% e ujit që prodhohet (janar – mars 2009).

Ujërat e zeza shkarkohen pa u trajtuar në lumin e Osumit.

Zona e furnizimit në Kuçovë

Kuçova furnizohet kryesisht nga një zonë ujëmbajtëse në Çiflig, rreth 7 km në lindje të qytetit. Kapaciteti i Çifligut është i kufizuar në 18 orë në ditë për shkak të mbingarkesës së pompave të vjetra. Cilësia e ujit është mediokre. Janë raportuar shumë raste të ndotjes bakteriologjike.

Sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes janë në gjendje të keqe; veçanërisht linja e transmetimit nga burimi në qytet ka humbje të mëdha. Përveç blloqeve të apartamenteve, shumica e konsumatorëve në Kuçovë janë me matës (96%), por nuk ka matës për prodhimin ose shpërndarjen.

Me investimet e tashme do të ndërtohet një linjë e re transmetimi nga Berati në Kuçovë dhe Kuçova do të furnizohet më ujë nga burimi i Bugovës.

Kanalizimet derdhen pa u trajtuar.

1.05 Situata financiare, organizative dhe institucionale (NUKBK)

Gjendja financiare e NUKBK-së karakterizohet nga:

- Tarifa tepër të ulëta, ndërsa tarifat në të dyja zonat e furnizimit janë të ndryshme dhe harmonizimi duhet të përfundojë në vitin 2010;
- Subvencione të larta nga qeveria qendrore për shpenzimet operative. Këto subvencione do ulen së tepërmi në të ardhmen;
- Efikasitet i ulët në arkëtim në Berat dhe efikasitet i ulët në faturim në Kuçovë;
- Shpenzime të larta veçanërisht për personelin.

Kjo situatë nuk lejon shpenzimin e fondeve të mjaftueshme për mirëmbajtjen e rrjetit.

Organizimi i shoqërisë ndahet sipas dy zonave të furnizimit. Sfida kryesore do të jetë zhvillimi i një organizimi të përbashkët në lidhje me linjën e përbashkët të transmetimit, që do të lidhë së bashku të dyja sistemet.

Procedurat teknike janë të ndryshme në të dyja zonat për shkak të sistemeve të ndryshme të furnizimit. Procedurat tregtare dhe financiare janë kryesisht të ndara. Procedurat janë të mirëvendosura, por joefektive, pasi EDP-ja përdoret vetëm pak.

Problemet strukturore të NUKBK-së në lidhje me shërbimet e kërkuara tregohen me hollësi në anekset A-2.

1.06 Objektivat e programit (NUKBK dhe NUKL)

Objektivi i programit në vazhdim, si dhe për masën e trajnimit është furnizimi i popullatës me efikasitet me volum të mjaftueshëm me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të sigurt.

Objektivat e mëposhtëm mund të arrihen nga programi në vazhdim:

- Norma e lidhjes me sistemin qendror të ujit; më shumë se 95%;
- Furnizimi i vazhdueshëm me ujë: më shumë se 200 ditë në vit, 24 orë në ditë;

- Mikrobe *no coli form* në më shumë se 90% të kampionëve;
- Kapaciteti i prodhimit dhe shpërndarjes mbi ose i barabartë me 18 000 cbm/ditë;
- Humbjet teknike: më pak se 30%.

2. Masa e trajnimit

2.01 Objektivat e shërbimeve të kërkuara (NUKBK dhe NUKL)

Objektivat e masës së trajnimit, bazuar në objektivat e programeve të përmendura më lart, janë përmirësimi i qëndrueshmërisë ekonomike dhe teknike të PEA-s, si dhe të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me ujë dhe shërbimet e kanalizimeve, veçanërisht:

- Uljen e humbjeve duke u përqendruar në humbjet administrative është qëllimi kryesor, pasi siguron rritjen e kohës së furnizimit me ujë për popullatën, si dhe pavarësinë financiare të shoqërisë;
- Përmirësimi i efikasitetit të arkëtimit dhe faturimit nga riorganizimi dhe zhvillimi i procedurave moderne tregtare dhe financiare;
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare duke përdorur procedura financiare moderne dhe duke zhvilluar një plan për reduktimin e kostos;
- Përmirësimi i procedurave teknike (d.m.th., prodhimi, shpërndarja, mirëmbajtja).

2.02 Kriteret e përmbushjes (NUKBK)

Përgjithësisht, personeli i NUKBK-së duhet të ketë kompetencën të përmirësojë përmbushjen institucionale.

Përmirësimi do të matet me kriteret e mëposhtme të matjes (në fund të shërbimeve):

- Furnizim i pandërprerë me ujë: më shumë se 200 ditë në vit, 24 orë në ditë;
- Ulja graduale e ujit pa të ardhura (në më pak se 55%)[3], veçanërisht ulja e humbjeve administrative në më pak se 35% deri në vitin 2012;
- Rritja e efikasitetit të arkëtimeve 6 muaj (>85)[4];
- Rritja e efikasitetit të faturimit (>75);
- Mbulimi i kostos (para amortizimit) (100%)[5];

Kritere të tjera të përmbushjes që duhet të arrihen:

- Përqindja e lidhjeve të matura (65%);
- Konsumi i faturuar për frymë: (>95l/c/d)[6];
- Numri i punëtorëve për 1000 lidhje: 9;
- Numri i reduktuar i pretendimeve për klientë (objektivi përcaktohet në raportin e fillimit).

Piketat që duhet të respektohen (bazuar në fillimin e shërbimeve)

- Vendosja e EDP-së për faturimin dhe llogaritë (pas 6 muajsh);
- Plani i detajuar për uljen e kostos, i aprovuar nga bordi i menaxhimit dhe mbikëqyrës (pas 6 muajsh);
- Baza e të dhënave të konsumatorëve operative dhe e përditësuar (pas 12 muajsh);
- Menaxhim dhe kontroll i kualifikuar i humbjeve, duke përfshirë balancat e ujit për zona të ndryshme të furnizimit të caktuar (pas 18 muajsh);
- Aprovimet nga NUKBK/bordi mbikëqyrës për ndryshimet e rekomanduara organizative (referojuni detyrave përkatëse);
- MIS është funksionale (pas 12 muajsh);

---

[3] Llogaritje e NRW-së sipas terminologjisë "IWA Standard International Water Balance"

[4] Llogaritja e arkëtimeve (me bazë 6-mujore): Mbledhja nga aktivitetet kryesore (duke përfshirë arkëtimet e borxheve të vjetra)/ të ardhurat nga aktivitetet kryesore (duke përfshirë tatimet, tarifat etj.).

[5] Llogaritja e mbulimit të kostos:
Të ardhurat e arkëtuara nga aktivitetet kryesore (uji, shitjet e ujërave të zeza, tarifat e lidhjeve etj. Nuk përfshihen subvencionet.).
Shpenzimet operacionale (p.sh., materialet, kostoja e personelit, energjia, transporti, zyra, shërbimet e palëve të treta…)
Shpenzimet e mirëmbajtjes janë të paktën 10 euro për lidhje
Interesi dhe shpenzimet e tjera financiare (duke përfshirë detyrimet e masave të investimit)

[6] Llogaria e konsumit të faturuar për frymë:
Konsumi i faturuar për konsumatorët privatë / (numri i konsumatorëve privatë * numri mesatar i anëtarëve të ekonomisë shtëpiake)

- Sistemi i monitorimit për mirëmbajtjen dhe riparimin është funksional (pas 12 muajsh);
- Sistemi i monitorimit për pretendimet e klientëve është operacional (pas 9 muajve).

2.03 Detyrat e kërkuara dhe objekti i shërbimeve

PEA-të kërkojnë mbështetjen e një firme konsulence në lidhje me shërbimet për masën përkatëse të trajnimit. Shërbimet do të kryhen nga një konsulent menaxherial institucional dhe në bashkëpunim me subjektet kryesore të sipërpërmendur, si dhe në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit të programit të investimeve, me qëllim që të trajnohet NUKBK-ja me personelin e saj përkatës për të kaluar problemet strukturore të përcaktuara në aneksin A-2 dhe që të arrihen kriteret e përmbushjes të specifikuara më sipër. Situata e tashme e NUKL-së do të vlerësohet dhe masat e trajnimit do të propozohen dhe më pas ato do të realizohen nga Konsulenti pas aprovimit nga PEA, NUKL dhe KfW.

Është e një rëndësie themelore që shërbimet e konsulencës të orientohen rreptësisht nga zbatimi. Një qëndrim që ka raporte më të gjata studimore me lista rekomandimesh të shkruara që i lihen menaxhimit të ndërmarrjes për vlerësim dhe zbatim të mëvonshëm të mundshëm, është qartësisht jo i përshtatshëm. Në vend të kësaj, pritet që konsulentët të jenë të shpejtë në vlerësimin e nevojave që duhet të përmbushen në organizimin dhe të jetë në gjendje të identifikojë përmirësimet e duhura procedurale për sistemet e menaxhimit dhe rrjedhën e punës që më pas trajnohen dhe zbatohen së bashku me personelin në ngarkim të zbatimit të sistemeve dhe dhënies së rezultateve.

Kapitujt e mëposhtëm përshkruajnë detyrat specifike të masës së trajnimit. Ofertuesi propozon një metodologji logjike për të arritur këto detyra specifike në mënyrë paralele, duke përfshirë përkufizimin e prioriteteve dhe sekuencën e aktiviteteve që duhet të ndërmerren. Ofertuesi nuk duhet të kufizojë ofertën e tij/saj në detyrat e renditura në këta terma reference, por mund të zgjerojë fokusin e tij për sa të jetë e nevojshme për të arritur rezultatet e treguara.

Ofertuesi do të propozojë një sistem monitorimi në ofertën e tij/saj, për të matur përparimin e masës së trajnimit, me qëllim që të mundësohen korrigjime gjatë periudhës së masës së trajnimit nëse është e nevojshme.

Ofertuesi propozon një metodologji praktike për të arritur trajnimin në teori dhe "gjatë punës" për secilin nga rezultatet e pritshme.

Detyrat e veçanta që përmbushen veçmas për të dy PEA-të. Detyrat/rezultatet 1 deri 7 sigurohen nga NUKNK-ja, ndërsa detyrat/rezultatet 8 dhe 9 i takojnë NUKL-së.

2.03.1 Detyra/rezultati 1: Pakësimi humbjeve

Treguesit e matshëm: NRW, balanca e ujit (për secilën zonë furnizimi), faturimi për konsum për frymë, përqindje e lidhjeve me sahat, koha e furnizimit (për zona të ndryshme).

Konsulenti do të përqendrohet në uljen e humbjeve administrative dhe do të zhvillojë komunikimin ndërmjet departamenteve teknike dhe tregtare dhe do të bashkëpunojë me masat e investimit për të mbështetur zbulimin e humbjeve teknike.

Konsulenti do të trajnojë personelin e NUKBK-së për të analizuar dhe zbuluar humbjet.

Objekti i punëve për konsulentin do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- Prezantimin e balancave të standardizuara të ujit, preferohet për zona të ndryshme furnizimi;
- Mbështetje/trajnim në zhvillimin/përshtatjen e bazës së të dhënave për konsumatorët, duke përfshirë informacionin përkatës të nevojshëm për balancat e sipërshënuara;
- Trajnim dhe monitorim për përditësimin e bazës së të dhënave të klientëve/bazës së të dhënave të lidhjeve;
- Zhvillim të procedurave të sakta të punës për të zbuluar dhe parandaluar lidhje të paligjshme dhe anashkalimet e matësve të ujit, duke përfshirë monitorimin (bashkëpunim me masën e investimit), duke përfshirë trajnimin dhe monitorimin;
- Zhvillim, trajnim dhe monitorim të procedurave kundër klientëve debitorë (duke përfshirë prerjet, gjobat, procedurat e rilidhjes) dhe rekomandimet për rregullimin e organizimit të brendshëm;

- Vlerësim të pajisjeve të zbulimit të rrjedhjeve, trajnimin për zbulimin e rrjedhjeve dhe mbështetjen për ngritjen e një njësie të përhershme për zbulimin e rrjedhjeve (bashkëpunimi me masën e investimit);

- Marrja e miratimit të bordit të menaxhimit/mbikëqyrjes për organizimin e ri, duke përfshirë grafikun për zbatim (piketat);

- Monitorimi i masave, mbështetje: trajnimi gjatë punës.

2.03.2 Detyra/rezultati 2: Përmirësimi i procedurave financiare dhe tregtare

Treguesit e matshëm: Efiçenca në arkëtim (për grupe të ndryshme klientësh), numri i prerjeve, numri i ankesave të klientëve

Objekti i punëve për konsulentin përfshin, por nuk kufizohet në sa më poshtë:

• Trajnimi dhe mbështetja në prezantimin e ADP-së:

- vlerësimi i aplikimeve të disponueshme të faturimit dhe llogarive në Shqipëri (ose në gjuhën shqipe);

- tenderimi dhe prokurimi i programeve të faturimit dhe llogarive, duke përfshirë trajnimin teknik sipas nevojave sipas njohurive ekzistuese / nevojave të personelit;

- integrimi i programeve në organizimin e zhvilluar (shih më poshtë nëndetyrat e përmendura).

• Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të reja për leximin e matësve, faturimin dhe arkëtimin dhe integrimin e ADP-së:

- zhvillimi organizativ do të trajtojë të gjithë procesin tregtar, duke përfshirë monitorimin punës;

- përfitimi nga sinergjia, ekzekutimi i ADP-së do të centralizohet;

- marrja e aprovimit të bordit të menaxhimit/mbikëqyrjes për organizimin e ri, duke përfshirë grafikun për zbatim (piketat);

- në fazën e parë të prezantimit të EDP-së personeli trajnohet si të ngrejë një bazë të dhënash për klientët, si të mbledhë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të mbajë një sistem të përditësuar. Kjo detyrë organizative mbështetet nga konsulenti, ndërsa trajnimi teknik i programit realizohet nga ofruesi i programit.

• Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të reja të llogarive dhe integrimi i ADP-së:

- përveç procesit të llogarive financiare, zhvillimi organizativ përbëhet nga procesi i prokurimit dhe ruajtja, duke përfshirë të gjitha ndërfaqet për departamentin tregtar;

- llogaritë financiare dhe llogaritë materiale (duke përfshirë prokurimin) duhet të centralizohen;

- marrja e aprovimit të bordit të menaxhimit/mbikëqyrjes për organizimin e ri duke përfshirë grafikun për zbatim (piketat);

- konsulenti do të japë mbështetje organizative në çështjet e llogarive, ndërsa trajnimi teknik i programeve të llogarive do të ekzekutohet nga ofruesi i programit;

- duhet të prezantohen llogaritë e kostos që qendrës.

• Përmirësimi i procedurave dhe masave kundër klientëve debitorë (duke përdorur edhe bazën e re të të dhënave):

- zhvillimi i një procedure të detajuar (paralajmërimi, prerjet, tarifat për rilidhjet);

- mbështetja për zgjedhjen e personelit përkatës;

- vlerësimi i stimulimit financiar për ekipet e prerjeve;

- marrja e aprovimit të bordit të menaxhimit/mbikëqyrjes për organizimin e ri, duke përfshirë grafikun për zbatim. Arritja e përkushtimit nga bashkitë në lidhje me mbështetjen aktive të masave (piketat);

- monitorimi i masave, mbështetje: trajnim gjatë punës.

• Trajnimi i personelit të NUKBK-së në marrëdhëniet e klientit, mbështetje e fushatës së PR-së që informon në lidhje me masat e investimeve, përmirësimet e planifikuara dhe realizuara (instalimi i matësve të ujit, përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së ujit në Kuçovë) dhe prezantimi i shoqërisë së re në publik.

2.03.3 Detyra/rezultati 3: Zhvillimi i organizimit dhe procedurave teknike

Treguesit e matshëm: Koha e furnizimit (për zona të ndryshme), numri i personelit në njësi të ndryshme, numri i riparimeve.

Objekti i punëve për konsulentin përfshin, por nuk kufizohet në sa më poshtë:

• Zhvillimi i procedurave të reja teknike, veçanërisht për shpërndarjen e ujit (operacionet me valvulat e portave);

- për regjimin e furnizimit në Kuçovë pas përfundimit të masës së investimit;
- zbulimi i rrjedhjeve (referojuni detyrës/rezultatit 1);

• Përgatitja e një manuali mirëmbajtjeje të lehtë për përdorim dhe të shkurtër dhe trajnimi i personelit në aktivitetet e rregullta të mirëmbajtjes;

• Ngritja e një njësie teknike planifikimi dhe zhvillimi;

• Marrja e aprovimit nga bordi i menaxhimit/mbikëqyrjes për organizimin e ri, duke përfshirë grafikun për zbatimin (piketat);

• Trajnimi në përpilimin e hartave (CAD);

• Vlerësimi i zhvillimit të një stoku të vogël të përbashkët;

• Vlerësimi i përfitimit ekonomik të një njësie kalibrimi të matësve të ujit.

2.03.4 Detyra/rezultati 4: Realizimi i mbulimit të kostos dhe pavarësisë financiare

Tregues të matshëm: Mbulimi i kostos, numri i punonjësve/1000 lidhje

Objekti i punëve për konsulentin përfshin, por nuk kufizohet në:

• Përgatitjen e një ndarjeje të detajuar të kostos dhe mbështetjen e menaxhimit në zhvillimin e një plani për reduktimin e kostos;

• Përgatitjen e planit për zhvillimin e personelit/organizatës së bashku me menaxhimin, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet organizative të përmendura në detyra të tjera;

• Prezantimin e një sistemi informativ menaxherial të lehtë për t'u përdorur dhe të thjeshtë (MIS), duke përfshirë trajnim në përdorimin e tij. MIS-i duhet të përfshijë të paktën monitorimin e

- prodhimit dhe shpërndarjes së ujit, duke përfshirë NRW-në;
- leximin e matësve, faturimin dhe procedurën e arkëtimit;
- situatën financiare, duke përfshirë planin e reduktimit të kostos.

• Trajnimi i departamentit financiar për të rishikuar dhe përditësuar planin e biznesit, duke përfshirë përditësimin vjetor të llogaritjes afatmesme tarifore.

2.03.5 Detyra/rezultati 5: Turet studimore

Dy ture studimore te veprat e ujit në Shqipëri për menaxhimin e NUKBK-së duhet të planifikohen nga Konsulenti, me qëllim që të përftohet një koncept më i mirë për aspektet praktike në zbatimin e organizimit të brendshëm, llogarive, kostove, si dhe operimin dhe mirëmbajtjen. Veprat e ujit duhet të jenë të një mase të krahasueshme dhe duhet të kenë kaluar një proces të ngjashëm zhvillimi gjatë viteve të fundit.

2.03.6 Detyra/rezultati 6: Prokurimi i programeve, pjesëve kompjuterike, materialeve, shërbimeve të instalimit dhe trajnimi i jashtëm

Konsulenti, bazuar në vlerësimin e rekomandimet e tij organizative, vlerëson opsionet për infrastrukturën e EDP-së që duhet të prezantohet.

Ai paraqet një koncept duke përfshirë vlerësimin e hollësishëm të kostos, veçanërisht për licencat e programeve, pjesët e nevojshme kompjuterike dhe pajisjet e rrjetit, koston e instalimit dhe trajnimin e jashtëm (shih gjithashtu detyrat 2.3).

Konsulenti është përgjegjës për të gjithë procedurën e prokurimit dhe prezantimin e pajisjeve e materialeve, si dhe për sigurimin e shërbimeve të jashtme, duke marrë parasysh grafikun e përgjithshëm të trajnimit, veçanërisht në lidhje me detyrat 2 dhe 3.

2.03.7 Detyra/rezultati 7: Mbështetja në rinegociimin e marrëveshjes së kanalizimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe NUKBK-së.

Konsulenti do të mbështesë UK Berat Kuçova në rinegociimin me MF-në të kushteve të kanalizimit të një huaje të mëparshme të dhëna Qeverisë Shqiptare dhe kanalizuar në UK Berat-Kuçova.

2.03.8 Detyra/rezultati 8: Vlerësimi i rezultatit institucional të NUKL-së

Rezultati i matshëm: Vështrim i përgjithshëm në lidhje me rezultatin institucional, rekomandimin për përmirësimet dhe propozimin për detyrat që duhet të përmbushen. Treguesit kryesorë të rezultateve për vitin 2007, 2008, 2009 dhe 2010 (në vazhdim).

Konsulenti vlerëson hollësisht organizimin e NUKL-së, veçanërisht:

- Operacionet teknike, duke përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, organizimin e masave të rregullta për uljen e humbjeve, përgatitjen e balancave të ujit etj.;
- Organizimi tregtar dhe financiar i procedurave në lidhje me llogaritë, leximin e matësve, faturimin, mbledhjen, masat ndaj konsumatorëve debitorë;
- Bazat e të dhënave të klientëve, duke përfshirë regjistrimin e matësve të ujit.

Konsulenti do të paraqesë rezultatet e tij bazuar në masat e trajnimit (shihni aneksin A1) në raportin e fillimit dhe sigurimin e rekomandimeve të hollësishme dhe konkrete për përmirësimet që duhet të arrihen nga NUKL-ja dhe mbështetja e propozuar që duhet të jepet nga konsulenti. Masat përkatëse të trajnimit duhet të paraqiten në një grafik të detajuar për aktivitetin dhe duhet të mbulojnë të gjitha fushat e sipërpërmendura të operimit.

Të gjitha përmirësimet duhet të jenë të matshme dhe konsulenti paraqet një propozim për një model raportimi mujor, duke përfshirë treguesit e performancës që më vonë do të bashkëngjitet në të gjithë raportet mujore dhe semestrale.

2.03.9 Detyra/rezultati 9: Përmirësimi i procedurave teknike, financiare dhe tregtare të NUKL-së

Rezultati i matshëm: Treguesit e përmirësuar të përformancës

Konsulenti mbështet NUKL-në në fushat e trajtimit të detyrës 8. Programi i detajuar i punës duhet të aprovohet nga NUKL-ja dhe KfW-ja në fazën e fillimit.

3. Rezultatet dhe raportimi

Raportet fillestare. Jo më vonë se dy muaj pas nënshkrimit të kontratës. Raportet përfshijnë një propozim të saktë në lidhje me masat dhe aktivitetet e nevojshme për të arritur treguesit e kërkuar dhe rezultatet, me vlerësimin e kushteve në vend. Do të përgatiten dy raporte, një për secilën PEA. Raportet fillestare duhet të aprovohen nga PEA-të dhe KfW-ja.

Raportet duhet të përfshijnë çdo përshtatje të programit të punës së konsulentëve dhe duhet të përmbajë një përditësim të strukturës së raporteve semestrale për aprovim nga PEA-të dhe KfW-ja. Një program i hollësishëm dhe i plotë pune së bashku me një tabelë për parashikimin e likuiditetit do të paraqitet në raportet fillestare.

Konsulenti do të paraqesë raportet fillestare në një kopje te PEA-ja përkatëse dhe dy kopje te KfW-ja.

Raportet mujore. Meqenëse konsulenti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me NUKBK-në dhe NUKL-në, këto do të jenë vazhdimisht në dijeni për punën e konsulentëve. Me qëllim që të informohet edhe KfW-ja në lidhje me përparimin e punës, konsulenti do të përgatitë një përmbledhje të shkurtër për aktivitetet kryesore dhe ngjarjet kryesore në anglisht, që duhet të paraqiten në ditën e fundit të çdo muaji.

Këto raportet duhet të jenë të ndarë për secilën PEA dhe të kufizuara në një faqe për secilën, të fokusohen problemet dhe qëndrimet (e raportuara së fundmi) dhe si t'i zgjidhin ato dhe dërgohen KfW-së dhe PEA-ve me e-mail (projekt-modeli në aneksin 1-3).

Raportet semestrale. Jo më vonë se katër javë pas periudhës përkatëse të raportimit. Këto raporte semestrale përmbajnë informacion mbi ndryshimet në sektorin e politikës dhe informacionin mbi zhvillimet, problemet e hasura, arritjet e aktiviteteve të masave të trajnimit, duke përfshirë monitorimin e treguesve dhe risqeve, kontrollin e kostos dhe përmbushjen e kritereve të programit, si dhe shërbimet e konsulentit. Devijimet nga planifikimi duhet të jenë të mirëbazuara. Për më tepër, nëse ka një devijim nga plani, raporti duhet të shpjegojë se si kjo do të ndikojë mbi masat e mbetura dhe llogaritjen e kostos dhe nëse ndryshimet në plan janë të nevojshme (projekt modeli i aneksit 1-4). Raportet semestrale përgatiten veçmas për secilën PEA. Raportet semestrale do të kërkojnë

aprovimin e PEA-ve dhe KfW-së. Konsulenti do të paraqesë raporte në një kopje te PEA-ja përkatëse dhe dy kopje te KfW-ja.

Raportet përfundimtare. Jo më vonë se gjashtë javë nga përfundimi i shërbimeve. Ai përmban dokumentin përfundimtar mbi masat e trajnimit, aktivitetet, rezultatet, financat, kontributet e NUKBK-së dhe NUKL-së, kushtet dhe fushat për vëmendje në të ardhmen.

Meqenëse kohëzgjatja e shërbimeve për NUKL-në do të jetë më e shkurtër se për NUKBK-në, raporti përfundimtar për PEA NUKL do të jepet për rrjedhojë në fund të masës së trajtimit në Lushnjë.

Në fund të të gjithë projektit (fundi i shërbimeve përkatëse në Lushnjë dhe Berat-Kuçovë), do të organizohet një tryezë e rrumbullakët nga konsulenti me qëllim që të paraqesë dhe diskutojë raportet përfundimtare, rezultatet e masës së trajnimit dhe zhvillimin e kritereve të punës.

Raportet përfundimtare do të kërkojnë aprovimin PEA-ve dhe KfW-së. Konsulenti do të paraqesë raporte në një kopje te PEA-ja përkatëse dhe dy kopje te KfW-ja.

Si raporti fillestar dhe ai përfundimtar duhet të ndahen për secilën PEA, që përmban rezultatet, përmbledhjen dhe përfundimet dhe një numër të përshtatshëm të volumeve që përmbajnë anekset që paraqesin të gjitha hollësitë, të dhënat përkatëse dhe analizat dhe çështjet e tjera të nevojshme për të kuptuar raportin kryesor. Një raport përmbledhjeje ekzekutive paraqet një vështrim të përgjithshëm mbi situatën bazë, rezultatet, veprimet që duhet të ndërmerren, strategjinë e zbatimit, grafikun kohor, grafikun e kostove, sipas rastit.

Të gjitha raportet duhet të paraqiten në anglisht. Raportet fillestare, semestrale dhe përfundimtare duhet të paraqiten në anglisht dhe shqip.

Të gjitha raportet duhet të përgatiten në formatin DIN A4. Një volum i veçantë në DIN A3 duhet të përgatitet dhe të përmbajë të gjitha planet, skicimet dhe fotografitë, sipas nevojës.

Të gjitha raportet (dhe kopjet) duhet të paraqiten edhe në format elektronik që të jenë të përputhshme me programet MS Office (përkatësisht *pdf, Word, Excel*).

Afatet e dhëna për raportin fillestar, raportet semestrale dhe raportin përfundimtar kuptohen për paraqitjen e projekt versioneve të raporteve në formë elektronike. Versionet përfundimtare paraqiten jo më vonë se 2 javë pas marrjes së komenteve nga PEA-të dhe KfW-ja.

Kushtet e pagesës për pagesën paraprake dhe të fundit përcaktohen në Kushtet e veçanta të tenderit. Shumat që mbeten duhet të ndahen në këste pasuese semestrale me mbërritjen e raporteve semestrale. Pagesat për Beratin-Kuçovën dhe Lushnjën do të trajtohen veçmas.

4. Kërkesat

Projekti është planifikuar për një periudhë prej 24 muajsh për shërbimet që duhet t'i jepen NUKBK-së dhe 12 muaj për shërbimet që i takojnë NUKL-së.

Ofertuesi propozon një grafik dhe tabelë të detajuar zbatimi, duke treguar kontributet dhe vendndodhjen e personelit lokal dhe ndërkombëtar, si pjesë e ofertës së tij/saj.

4.01 Personeli

Bazuar në fushat e ekspertizës dhe detyrat e përmendura më sipër, propozohet që ekipi i konsulencës të përbëhet nga të paktën ekspertët e jashtëm dhe lokalë të mëposhtëm:

a) Një ekspert ndërkombëtar për menaxhimin me minimalisht 10 vjet eksperiencë profesionale në fushat e menaxhimit institucional të furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

Kërkohet eksperiencë e veçantë në fushat e zhvillimit organizativ, zhvillimit tregtar dhe financiar, si dhe eksperiencë IT-je.

Ai/ajo duhet të punojë si menaxher projekti dhe duhet të demonstrojë eksperiencën administrative dhe menaxheriale.

b) Ekspertët e tjerë ndërkombëtarë dhe lokalë afatshkurtër dhe afatgjatë me fokus të veçantë në:

- Operacionet dhe mirëmbajtjen e ujit;
- Zbulimi i rrjedhjeve;
- PR.

kërkohen për të kryer shërbimet e konsulencës që kërkohen për të arritur kriteret e caktuara të performancës dhe për të mbuluar çështjet e treguara më sipër.

c) Përveç ekspertëve afatshkurtër, konsulenti ofron konsulencën me orar të plotë lokale për shërbimet që duhet t'i jepet NUKL-së (12 muaj);

d) Të paktën një përkthyes lokal duhet të jetë pjesë e ekipit të konsulencës.

Nëse një anëtar i personelit të konsulentit duhet të zëvendësohet, zëvendësimi duhet të sigurojë të paktën kualifikimet dhe eksperiencën e barasvlershme. Çdo zëvendësim i nënshtrohet aprovimit nga KfW-ja dhe PEA-të.

4.02 Personeli mbështetës dhe mbështetja

Menaxhimi efikas dhe personeli mbështetës duhet të jetë i disponueshëm për të mbikëqyrur ekipin në vend dhe jashtë shtetit.

Të gjitha shpenzimet në lidhje me mbështetjen duhet të përfshihen në norma tarifore. Të gjitha kostot në lidhje me personelin mbështetës duhet të përfshihen në normat e ekspertëve.

4.03 Lehtësitë që duhet të jepen nga punëdhënësi ose palët e tjera

Do të jetë detyrë e konsulentit të mbajë kontakt të ngushtë me NUKBK-në dhe NUKL-në për të gjitha aspektet e punës. Si çështje parimi, të gjitha komunikimet formale në lidhje me punën do të drejtohen në vëmendje të NUKBK-së dhe NUKL-së.

NUKBK-ja dhe NUKL-ja ofrojnë pa pagesë të gjithë informacionin ekzistues, të dhënat, raportet dhe hartat në masën që janë ekzistuese dhe do të asistojnë konsulentin në marrjen e informacionit përkatës dhe materialet nga institucionet qeveritare dhe autoritetet shtetërore për sa të jetë e mundur. Megjithatë, është detyra e konsulentit të kontrollojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij informacioni. Informacioni, të dhënat, raportet etj., që përmenden më sipër, do të ofrohen për përdorim të pakufizuar të konsulentit gjatë dhënies së shërbimeve të propozuara.

Në përgjithësi, NUKBK-ja dhe NUKL-ja do të mundësojë të gjitha lejet, autorizimet dhe licencat e personelit që kërkohen për përmbushjen e shërbimeve të konsulentit në Shqipëri. Ai do të asistojë gjithashtu konsulentin në zhdoganimin e të gjitha pajisjeve, materialeve dhe sendeve personale që importohen për qëllimin e punës së tij (sipas rastit).

Përgjithësisht, punëdhënësi jep atë asistencë në lidhje me çështjet që dalin përkatësisht në Berat, Kuçovë dhe Lushnjë.

Punëdhënësi jep të paktën (me kërkesë të konsulentit) asistencë të arsyeshme në marrjen e kopjeve të ligjeve shqiptare që lidhen me zbatimin e projektit.

4.04 Lehtësitë që ofrohen nga konsulenti

Konsulenti duhet të rregullojë me shpenzimet e tij një zyrë të pajisur rregullisht dhe pajisjet e nevojshme të zyrës, duke përfshirë mjetet e komunikimit, mjetet e transportit dhe çdo shpenzim tjetër.

Gjatë periudhës së projektit, konsulenti është përgjegjës për:

- Dhënien e pajisjeve në lidhje me zyrën, pajisjet e zyrës, pjesët kompjuterike dhe programet, me qëllim që zyra të jetë tërësisht funksionale;
- Sigurimi i mjeteve të transportit dhe komunikimit;
- Çdo shpenzim për komunikimin (faks, e-mail, telefon);
- Ofrimin e shërbimeve të sekretarisë dhe përkthimit;
- Çdo shpenzim që shkaktohet nga riprodhimi dhe printimi i dokumenteve.

Konsulenti është tërësisht përgjegjës për të gjithë akomodimin dhe sigurimet për personelin e tij në Shqipëri në të gjithë kohëzgjatjen e shërbimeve, duke përfshirë transportin nga dhe për në vendin e punës dhe për në vendin e origjinës.

Konsulenti është përgjegjës për pajisjet dhe automjetet e punës dhe kostoja përkatëse do të paraqitet veçmas në propozimin financiar.

Anekset

Aneksi A-1 Informacioni i ofruar për NUKBK-në dhe NUKL-në
Aneksi A-2 Arritjet financiare, situata organizative dhe institucionale në NUKBK
Aneksi A-3 Modeli i raportit mujor
Aneksi A-4 Modeli i raportit semestral

ANEKSI A-1
INFORMACIONI I DISPONUESHËM PËR NUKBK-NË DHE NUKL-NË

Informacioni i mëposhtëm mbi NUKBK-në dhe NUKL-në është i disponueshëm në CD:

- Studimi i fizibilitetit për bashkimin në një shoqëri të përbashkët për furnizimin me ujë për ndërmarrjet e Beratit dhe Kuçovës – Fichtner – maj 2006
- Furnizimi me ujë në Shqipërinë e Mesme, komponentët Lushnja, Berat dhe Kuçova, raporti përfundimtar i projektimit, JV Dorsch - IncoWest – maj 2006
- Furnizimi me ujë dhe kanalizimi, shoqëria e menaxhimit të biznesit Lushnja - Raporti përfundimtar, JV Dorsch - IncoWest – gusht 2007
- Plani i biznesit 2008 – 2012 (projekti) Berat/Kuçovë shoqëria rajonale e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve – NUKB, NUKK – 2008;
- Raporti i përfundimit të projektit furnizimi me ujë në Shqipërinë e Mesme, JV Dorsch – IncoWest – tetor 2009;
- Raporti i identifikimit të projektit për infrastrukturën bashkiake II, Bockelmann/Kaeser – nëntor 2009;
- Raporti i projektit përfundimtar në Shqipërinë e Mesme, komponenti Berat dhe Kuçovë, Dorsch + IncoWest – dhjetor 2009

ANEKSI A-2
ARRITJET FINANCIARE, SITUATA ORGANIZATIVE DHE INSTITUCIONALE E NUKBK-SË

Problemet strukturore të NUKBK-së në lidhje me situatën financiare, operative dhe institucionale janë të ngjashme me shoqëritë e tjera të krahasueshme të ujësjellësit në Shqipëri. Një sfidë organizative shtesë përbëhet nga bashkimi i dy shoqërive të mëparshme të pavarura.

Informacioni i mëposhtëm ofron një vështrim të përgjithshëm të situatës në qershor 2009.

Organinograma, plani i personelit dhe kualifikimi i personelit



Pas bashkimit, organizata fillimisht u ndryshua në mënyrë të tillë që selia e përbashkët është tashmë zyra në Berat ku gjendet drejtori i përgjithshëm, drejtori teknik, drejtori financiar dhe shefi i departamentit tregtar. Operacionet tashmë janë ndarë në dy sektorë sipas zonave të ndryshme të furnizimit.

Secili departament ka njësi organizative të ngjashme, një për secilin sektor. Drejtorët janë njëkohësisht menaxherë të njësive të tyre të sektorit Berat, ndërsa menaxherët e njësisë emërohen për njësitë përkatëse të sektorit të Kuçovës. Funksionet e përgjithshme të menaxhimit për sektorin e Kuçovës janë detyra e sektorit të menaxhimit Kuçovë.

Departamenti teknik

Operacionet e njësive të të dyja zonave të furnizimit ndryshojnë sipas ambientit të ndryshëm teknik.

Të dyja zonat janë teknikisht të ndara për momentin, regjimet e përgjithshme të furnizimit janë të ndryshme dhe kështu që nevojitet ekspertizë dhe njohuri e ndryshme për situatat e caktuara lokale. Kjo mund të jetë një nga arsyet pse organizatat e të dyja njësive teknike vazhdojnë të jenë të ndara dhe personeli rrallë është i përbashkët për sektorët.

Prodhimi dhe shpërndarja

Kualifikimet dhe ekspertiza e veçantë për drejtimin e valvulave të shumta të portave për furnizimin e zonave të presionit/furnizimit gjenden në Berat, megjithëse rezultati i këtyre përpjekjeve të drejtimit mund të përmirësohej së tepërmi nëpërmjet instalimit të pajisjeve të thjeshta matëse. Vetë operacionet e valvulave të portave nuk kërkojnë aftësi të veçanta. Kjo është arsyeja pse

operacionet menaxhohen nga rojet. 15% e popullatës së furnizuar marrin 24 orë ujë në ditë, ndërsa koha e furnizimit për konsumatorët ndryshon çdo ditë.

Për prodhimin e ujit në Kuçovë, punëtorët e specializuar për mirëmbajtjen e funksionimin e pompave të puseve dhe stacioneve të pompimit janë të nevojshëm dhe të disponueshëm (elektricistë, pompistë). Koha e furnizimit më ujë në Kuçovë është rreth 5 orë në ditë për çdo zonë. Grafiku i furnizimit është në intervale të ndryshme. Në total 89 punëtorë nevojiten për të bashkërenduar shpërndarjen e ujit në zona të ndryshme të furnizimit. Pas përfundimit të suksesshëm të masave të investimit, veçanërisht linja e transmetimit që lidh Kuçovën dhe burimin e Bugovës, dhe nëse ulen humbjet, do të arrihet furnizimi me ujë 24 orë. Organizimi do të ndryshojë së tepërmi pasi operatorët nuk do të nevojiten përherë te valvulat e portës. I gjithë regjimi i furnizimit do të ndryshojë. Organizata duhet të jetë e përgatitur për këtë situatë të re të zonës së përbashkët të furnizimit.

Mirëmbajtja

Pjesa më e madhe e anëtarëve të personelit të ekipeve të mirëmbajtjes janë punëtorë të kualifikuar. Pajisjet e zbulimit të rrjedhjeve janë të disponueshme dhe disa persona janë trajnuar për të përdorur këto pajisje, por meqenëse nuk ka fonde për mirëmbajtje aktive, nuk realizohen zbulimet e rrjedhjeve në praktikë. Mund të jetë i nevojshëm një trajnim shtesë për të riaktivizuar personelin.

Drejtori teknik ka kompjuterin e vetëm të departamentit teknik; nuk ka asnjë njohuri tjetër IT-je në të gjithë departamentin. Menaxheri i sektorit në Kuçovë (inxhinier me profesion) ishte i vetmi person që kishte njohuri IT-je.

Departamenti financiar dhe tregtar

Anëtarët e personelit të departamenteve financiare dhe tregtare kanë minimalisht arsim të mesëm, menaxherët kanë diploma universiteti në ekonomi. Drejtori financiar dhe menaxheri i njësisë financiare për sektorin e Kuçovës janë punësuar së fundi dhe u duhet pak kohë për të njohur punën e tyre të re.

Meqenëse të dy departamentet përdorin ADP-në vetëm për përgatitjen e korrespondencës, nuk ka asnjë njohuri IT-je në organizatë. Para se të fillojë prezantimi i propozuar të faturimit me kompjuter dhe mbajtja e llogarive në këtë mënyrë duhet të bëhen ndryshime organizative dhe të zbatohen, duke përfshirë përgjegjësitë e reja dhe procedurat e reja të punës.

Pajisjet dhe programet kompjuterike EDP

E gjithë organizata po punon pothuajse pa përdorur EDP-në. 6 kompjuterët ekzistues përdoren për përgatitjen e korrespondencës. Vetëm në Kuçovë, menaxheri i sektorit e përdor kompjuterin e tij për të regjistruar rrjetin e sektorit të tij (AutoCAD). Personat e mëposhtëm kanë mundësi të përdorin kompjuterët:

Kompjuterët janë të vjetër dhe të papërshtatshëm për faturimin dhe llogaritë moderne ose për aplikimet teknike të programeve. Nuk ka internet (LAN) dhe rrjet. Nuk ka procedura mbështetëse.

Kushtet ekonomike të NUKBK-së

Situata e përgjithshme ekonomike në vitet e fundit është karakterizuar nga tarifat e ulëta dhe subvencione të larta nga qeveria qendrore. Këto fonde nuk janë shpenzuar për investimet, por janë parashikuar vetëm për të subvencionuar operacionet (pagat, energjinë elektrike). Pas transferimit të pronësisë nga qeveria qendrore tek ajo lokale në vitin 2007, ulja e subvencioneve është e dukshme nga viti në vit. Subvencionet dhe donacionet arrijnë në 36% të të ardhurave të përgjithshme të NUKBK-së në vitin 2008. Duhet të pritet që ulja e fondeve nga qeveria do të vazhdojë, që mund të çojë në një situatë serioze financiare për shoqërinë, nëse nuk merret ndonjë masë tjetër.

Pasqyra e të ardhurave Të ardhurat (shitjet) Subvencionet dhe dhurimet Të ardhura të tjera (jooperative)	**Berat+Kuçovë** 2007 ALL 118 425 408 100 021 126 32 115	**%** +3% -29% +135 33%	**NUKBK 2008** ALL 122 256 549 71 170 440 4 378 280	**Nga totali %** +62% +36% +2%
Totali i të ardhurave Shpenzimet materiale Pagat Sigurimet sociale	218 478 649 16 826 848 73 440 167 14 851 574	+9% +12% +5% +8%	197 805 269 -18 906 998 - 76 804 211 - 15 990 034	+100% -10% -39% -8%
Shpenzimet për personelin Amortizimi Energjia elektrike Shpenzime të tjera	88 291 741 30 254 900 0 76 156 967	+5% +15% - 69%	-92 794 245 -34 735 303 -25 850 317 -23 929 694	-47% -18% -13% -12%
Totali i shpenzimeve	211 530 456	-7%	-196 216 557	-99%
Fitimi/humbja operative Interesi Fitimi/humbja mbi shkëmbimin Të ardhura/shpenzime të tjera financiare	**6 948 193** 1 222 146 1 272 376 0	**-77%** +2% +129%	**1 588 712** -1 247 097 -2 917 568 -694 087	**+1%** -1% -1% -0%
Fitime/humbje financiare	-2 494 522	+95%	-4 858 752	-2%
Fitimi/humbja para tatimeve Tatimi mbi fitimet	**4 453 671** 321 131	**-173%** -27%	**-3 270 040** 229 156	**-2%** -0%
Fitimi/humbja vjetore	**4 141 540**	**-184%**	**-3 499 196**	**-2%**

Zëri më i rëndësishëm i kostos janë shpenzimet për personelin. Numri i punonjësve është në të njëjtin nivel si edhe para bashkimit (261) dhe shpenzimet për personelin arrijnë në 47% të të ardhurave totale (ose 76% të të ardhurave për ujë dhe kanalizime).

	Berat 2008 lekë	**Kuçova 2008 lekë**	**NUKBK 2008 lekë**
Pasqyra e fluksit të parasë Fitimi/humbjet pa tatime Subvencione + Amortizim +Vlera e aseteve të shitura -Tatim mbi të ardhurat +/- Inventar +/- Të arkëtueshme (konsumatorë) +/- Të arkëtueshme të tjera afatshkurtër +/- Detyrime të tjera afatshkurtër	 2 177 128 16 335 927 19 676 256 88 094 229 156 206 120 -18 095 651 784 965 8 361 177	 -5 447 168 -54 834 513 15 059 047 1 849 583 0 1 989 869 484 239 802 348 14 015 320	 -3 270 040 -71 170 440 34 735 303 1 937 677 -299 156 1 783 749 -18 943 890 1 587 313 22 376 497
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative - Subvencione	**-3 779 234** 16 335 927	**-27 413 753** 54 834 513	**-31 192 987** 71 170 440
Fluksi operativ i parasë +/- prokurimi i aseteve afatgjatë	**12 556 693** 49 146 511	**27 420 760** 32 100 679	**39 977 453** 81 247 190
Fluksi i parasë nga investimet +/- Rritja e detyrimeve financiare afatgjatë +/- Grantet (afatgjatë)	**-49 146 511** 44 033 259 10 480 927	**-32 100 679** 26 069 631 23 164 033	**-81 247 190** 70 102 890 33 644 960
Fluksi i parasë nga aktivitetet financiare	**33 552 332**	**2 905 598**	**36 457 930**
Fluksi i parasë	**-3 037 484**	**-1 774 321**	**-4 811 807**
Para në dorë dhe para në bankë (1.1.) Para në dorë dhe para në bankë (31.12.)	5 445 888 2 408 402	2 765 732 991 411	8 211 620 3 399 813

Pasqyra e fluksit të parasë reflekton situatën ekonomike të shoqërisë që tregon humbjen e parave nga operimi i aktiveve të 31 mil lekëve, nga të cilat 24 mil lekë nga sektori i Kuçovës.

Analiza e situatës ekonomike duhet të bëhet për të dy sektorët veçmas pasi ambienti tregtar është tepër i ndryshëm.

Sektori Berat

Për shkak të shpërndarjes me rrjedhje të lirë, humbjet tepër të larta prej 86% (1-3 2009) duken se nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin financiar, kostoja e prodhimit është relativisht e ulët. Kjo mund të jetë e vërtetë për humbjet teknike, por jo për humbjet administrative,

të shkaktuara nga përqindja e ulët e lidhjeve me matës (14% e lidhjeve dhe 22% e konsumit matës) dhe pjesa tjetër është harxhim dhe marrje e paligjshme e ujit.

Kostoja e personelit (55% e të ardhurave totale) bazohet mbi procedurat për të furnizuar me ujë bashkërisht zonat e ndryshme të furnizimit (49 operatorë të valvulave të portave).

Klientët me tarifa fikse konsumojnë zakonisht më shumë se konsumi i vlerësuar. Konsumi mesatar për frymë për konsumatorët shtëpiakë është 110 l/c/d (1-3 2009).

Një proces tjetër i kostos është procesi i leximit të matësve dhe faturimit, që ekzekutohet pa përdorur ADP-në.

Fondet që mbeten të cilat shpenzohen për materialin e riparimit/mirëmbajtjes janë jo më pak se 900 lek/lidhje/vit që është të paktën 30% më i ulët sesa është e nevojshme (bazuar në një tregues >10 Euro p.a./lidhje). Kjo shumë nuk përfshin rezervat për rindërtime.

Sektori i Kuçovës

Situata ekonomike e zonës së furnizimit të Kuçovës karakterizohet nga kosto të larta të energjisë elektrike (pompimi). Këto shpenzime shtesë janë subvencionuar në periudhat e vona. Struktura e kostos dhe tarifave të Sektorit bazohet në këto fonde. Një reduktim i këtyre subvencioneve nuk mund të thithej në situatën e tashme.

Ndryshe nga situata në Berat, pjesa më e madhe e lidhjeve në Kuçovë janë me matës (96%). Megjithatë, kjo nuk do të thotë që humbjet administrative janë më të ulëta, për shkak të një numri të madh të pikave të lidhjes që janë në pronësinë e klientëve. Lexuesit e matësve nuk mund të shkojnë te matësi i ujit dhe lidhja e klientëve në tokën e tyre favorizon lidhjet paralele.

Një vështrim i përgjithshëm i procedurave të leximit/faturimit duhet të merret parasysh, pasi tashme lexuesi i matësit e shkruan faturën e vend dhe në fshatra arkëtimet bëhen nga i njëjti person gjatë të njëjtës vizitë. Ky bashkim përgjegjësish mund të jetë një shkak tjetër pasaktësish në lexime.

Konsumi për frymë i faturuar për klientët shtëpiakë në Kuçovë është vetëm 46 l/c/d (1-3 2009). Kjo vlerë e ulët e konsumit të faturuar është problemi kryesor tregtar i sektorit.

Një problem tjetër është numri i madh i personave të punësuar. Treguesi i rreth 11 punonjësve/1000 lidhje është i ngjashëm me sektorin e Beratit dhe të paktën 30% më i lartë. Kostoja e personelit në vitin 2008 ka qenë më e lartë se të ardhurat.

Megjithëse subvencionet dhe donacionet në vitin 2008 kanë arritur në 66% të të ardhurave totale, sektori e mbylli vitin me një humbje prej 5.4 mil lekë (=20% të të ardhurave për ujë/kanalizime).

Tre muajt e parë të vitit 2009 tregojnë një pamje të ngjashme, pasi subvencionet janë përsëri pothuaj 50% të të ardhurave dhe menaxheri i sektorit përmendi problemet e shkaktuara nga subvencionet e "vonuara".

Procedurat e leximit të matësve, faturimit dhe llogarive

Të gjitha procedurat e faturimit dhe llogarive realizohen pa ADP. Rutina përgjithësisht është e mirëvendosur dhe janë prezantuar proceset elementare të kontrollit dhe monitorimit, por procedurat harxhojnë kohë dhe janë të papërshtatshme për shkallën e shoqërisë.

Leximi i matësve dhe faturimi

Meqë zonat e furnizimit janë të ndara, leximi i matësve dhe faturimi është gjithashtu i ndarë.

Sektori Berat

Pjesa më e madhe e lidhjeve janë pa matës (88% e konsumatorëve shtëpiakë, 64% e ndërmarrjeve dhe 24% e institucioneve publike).

Procedurat e leximit të matësve dhe faturimit ekzistojnë efektivisht (në lidhje me mjetet e disponueshme), por jo efikase (procedura harxhon shumë kohë dhe nuk përdoret EDP-ja).

Konsumatorët debitorë vizitohen nga "policia e ujit" dhe detyrohen të paguajnë ose NUKBK ua pret ujit. "Policia e ujit" përbëhet nga 15 punonjës.

Sektori i Kuçovës

Pjesa më e madhe e lidhjeve është me matës (96% e konsumatorëve shtëpiakë, të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet publike). Procedura e leximit, faturimit dhe arkëtimit është e ngjashme me ato në sektorin e Beratit, por lexuesit e matësve nuk mund të shkojnë te matësi pasi vendet e

lidhjes janë zakonisht në pronën private. Në fshatra, lexuesit e matësve bëjnë mbledhjen e parave (bashkim problematik përgjegjësish).

Për shkak të matësve të vjetër dhe lidhjeve të shumta paralele të paligjshme, konsumi i faturuar në sektorin e Kuçovës është tepër i ulët (46 l/c/d).

Llogaritë

Mbajtja e llogarive kryhet veçmas për çdo sektor, duke përfshirë llogari bankare të veçanta dhe TVSH-ja paguhet veçmas. Drejtori financiar konsolidon rezultatet me bazë semestrale për qëllime të brendshme. Në fund të vitit një ekspert i jashtëm kontabilist përgatit raportin vjetor – përsëri nëpërmjet bashkimit të rezultateve të të dy sektorëve.

Asnjë nga punonjësit e departamentit financiar nuk ka eksperiencë për kontabilitet të kompjuterizuar (libri i madh, llogaritë e materialeve, menaxhimi i stoqeve).

Sistemi i tarifave

Një prej objektivave të shoqërisë së bashkuar është unifikimi i tarifave në të dy sektorët. Plani i biznesit jep një propozim të qartë për të arritur të njëjtat tarifa në të njëjtët sektorë deri në vitin 2010. Hapi i parë në këtë drejtim është ndërmarrë në kuadrin e rritjes në vitin 2009.

Tarifat e reja janë si më poshtë:

	Sektori Berat		**Sektori Kuçovë**		**NUKBK Totali**	
	shkurt	**mars**	**shkurt**	**mars**	**shkurt**	**mars**
Tarifat e ujit (lekë/m^3)					ponderuar	ponderuar
Private	25	28	30	35	26	29
Ndërmarrje	80	95	80	95	88	95
Institucione	70	80	60	80	69	80
Tarifat e kanalizimeve (lekë/m^3)						
Private						
Ndërmarrje	4	6	5	6	4	6
Institucione	10	12	10	12	10	12
	7	10	8	10	7	10

Të gjitha tarifat, përveç tarifës së ujit për konsumatorët shtëpiakë, janë unifikuar në të dy sektorët.

Megjithëse rritja e tarifës së realizuar në vitin 2009 ka qenë më e lartë se e përmendur në planin e biznesit, nuk është aspak e mjaftueshme për të përmirësuar situatën financiare dhe të mbulojë shpenzimet (të paktën operative). Kjo mospërputhje shkaktohet nga përmirësimet e papërmbushura në faturim, arkëtim dhe ulje të kostos.

Kapaciteti i njësive teknike të operimit

Operacionet teknike ndahen në njësi për:

- prodhimin e ujit;
- shpërndarjen e ujit;
- mirëmbajtjen e sistemit të ujit;
- mirëmbajtjen e kanalizimeve.

Secili prej këtyre njësive ekziston dy herë, një herë për secilin sektor.

81 persona janë të punësuar në njësitë e mirëmbajtjes për ujësjellësin dhe kanalizimet (62 në sektorin e Beratit, 19 në sektorin e Kuçovës). Pjesa më e madhe e tyre janë punëtorë të kualifikuar ose gjysmë të kualifikuar, por aktivitetet e mirëmbajtjes janë të kufizuara nga fonde të pamjaftueshme për materialet dhe me mjete dhe pajisje të vjetra. Kjo është arsyeja pse nuk ka koncept mirëmbajtjeje të përpiluar për momentin. Punët e kryera tashmë mund të bëheshin me një numër tepër më të vogël punëtorësh.

Përpjekjet e njësive janë të kufizuara për punët e riparimit emergjent. Konsulenti teknik e përshkruan qëndrimin e tyre si “art improvizimi”.

Të dy sektorët kanë prezantuar "sportelet e shërbimit" ku konsumatorët mund të paraqesin kërkesat dhe ankimet e tyre. "Sporteli i shërbimit" ia kalon kërkesat departamentit tregtar dhe teknik, ku dhe zgjidhet problemi.

ANEKSI A-3
MODELI I RAPORTIT MUJOR

Muaj/vit

Emri i projektit		Klienti	
Nr. i marrëveshjes së financimit		Financimi	
Rajoni i projektit		Periudha e raportimit	
Konsulenti			

Personel në terren			
Aktivitetet kryesore			
Fondet e disbursuara (afërsisht)	Artikujt kryesorë	Periudha e raportimit euro	Totali euro
Problemet e hasura	a) b)		
Zgjidhjet e sugjeruara	a) b)		
Statusi i problemeve të mëparshme	a) b)		
Aktivitetet e planifikuara			
Grafiku			
Të tjera			

ANEKSI A-4
MODELI I RAPORTIT SEMESTRAL

Kapitulli I: Hyrje
Kapitulli II: Të dhënat thelbësore

Emri i projektit	
Rajoni i projektit	
Klienti	
Financimi	
Nr. i marrëveshjes së financimit	
Konsulenti	
Shuma e kontratës së konsulencës (euro)	
Fondet totale të programit (euro)	
Fillimi kontraktual i projektit	
Fondi i planifikuar i projektit	

Kapitulli III:	Aktivitetet
Nëkapitulli1.01:	Aktivitetet gjatë periudhës së raportimit
Nëkapitulli1.02:	Aktivitetet e planifikuara
Kapitulli IV:	Problemet
Nëkapitulli1.03:	Problemet e hasura
Nëkapitulli1.04:	Zgjidhjet e sugjeruara
Nëkapitulli1.05:	Statusi i problemeve të mëparshme
Kapitulli V:	Informacioni kontraktual dhe financiar
Nëkapitulli1.06:	Situata kontraktuale
Nëkapitulli1.07:	Kontrolli i kostos për punët e ndërtimit dhe prokurimet
Nëkapitulli1.08:	Parashikimi i fluksit të kostos
Nëkapitulli1.09:	Shërbimet e konsulentës
Kapitulli VI:	Treguesit e punës (statusi fillestar, statusi i tashëm, shkaku i ndryshmit, masat e propozuara)
Kapitulli VII:	Informacioni tjetër

ANEKSI B
LISTA E FIRMAVE TË PARAZGJEDHURA

Konsulentët e mëposhtëm, të renditur në rend alfabetik, janë parazgjedhur:
- Haskoning Nederland B.V. / Vites-Evides International / S.E.Studio shpk
- IncoWest GmbH & Co KG / Dorsch Consult GmbH / Suewag Wasser GmbH / IncoWest Consult shpk
- MVV Decon GmbH / Valu Add shpk / rean 95 shpk
- Rodeco Consulting GmbH / Ingenuity ICE shpk / Institut për Studime të Sotme
- Sachsen Wasser GmbH / AHT Group / Anttrac / IE Consulting

ANEKSI C - 1
PREZANTIMI I CURRICULA VITAE

CV-ja e plotë e personelit të caktuar në mënyrë përfundimtare paraqitet në formën e përcaktuar më poshtë:

1. Mbiemri:
2. Emri
3. Data e lindjes
4. Shtetësia
5. Gjendja civile
6. Arsimi

Institucioni	
Datë: nga (muaj / vit) deri (muaj / vit)	
Gradat shkencore ose diplomat e marra	

7. Aftësitë gjuhësore, nota 1 (më e ulëta) deri 5 (më e larta) për kompetencën:

Gjuha	**Leximi**	**E folura**	**Shkrimi**

8. Anëtarësia në forume profesionale:
9. Aftësi të tjera:
10. Pozicioni i tashëm:
11. Vitet pranë firmës:
12. Aftësitë kryesore (që i takojnë periudhës):
13. Eksperienca specifike e vendit:

Vendi	**Data: nga (muaj / vit) deri (muaj / vit)**

14. Eksperienca profesionale (projektet):

Data: nga (muaj / vit) deri (muaj / vit)	
Vendndodhja	
Shoqëria	
Pozicioni	
Përshkrimi	

Data: nga (muaj / vit) deri (muaj / vit)	
Vendndodhja	
Shoqëria	
Pozicioni	
Përshkrimi	

15. Të tjera (p.sh., publikimet):

ANEKS C-2
PREZANTIMI I KARAKTERISTIKAVE TË PERSONELIT

Të dhënat e mëposhtme duhet të tregohen për ekspertët kryesorë për poste të ndryshme. Ato duhet të argumentohen në mënyrë të qartë në CV. Në rast mospërputhjeje gjatë vlerësimit, mbizotërojnë hollësitë në CV. Tabelat mund të përshtaten sipas propozimit dhe numrit të personelit kryesor të propozuar.

Drejtuesi i ekipit

Kriteret	**Emri**	
Arsimi profesional në lidhje me projektin dhe postin	Diploma(t)	
Eksperienca profesionale, nga puna e parë pas arsimit profesional	Vitet	
Eksperienca specifike në lidhje me projektin. Projekt i ngjashëm me detyra të ngjashme.	Nr. i projekteve brenda > 1 vit kontribut	
Eksperienca rajonale	Vendet	
Statusi i punësimit brenda firmës	Vitet si i punësuar	
Në rastin e një partneri/të punësuari: vitet e mbledhura gjatë detyrave afatshkurtra/afatgjata për ofertuesin	Vitet e mbledhura	
Eksperienca në drejtim (drejtues ekipi, menaxher projekti)	Nr. i projekteve	

Personel kryesor ndërkombëtar/i huaj profesional afatgjatë

Kriteret	Emri	NN1	NN2	NN3
	Posti/funksioni			
Arsimi profesional në lidhje me projektin dhe postin	Diploma(t)			
Eksperienca profesionale, nga puna e parë pas arsimit profesional	Vitet			
Eksperienca specifike në lidhje me projektin. Projekt i ngjashëm me detyra të ngjashme.	Nr. i projekteve me > gjashtë muaj kontribut			
Eksperienca rajonale	Vendet			
Statusi i punësimit brenda firmës	Vitet si i punësuar			
Në rastin e një partneri/të punësuari: vitet e mbledhura gjatë detyrave afatshkurtra/afatgjata për ofertuesin	Vitet e mbledhura			

Personel kryesor ndërkombëtar/i huaj profesional afatshkurtër

Kriteret	Emri	NN1	NN2	NN3
	Posti/funksioni			
Eksperienca profesionale, nga puna e parë pas arsimit profesional	Vitet			
Eksperienca specifike në lidhje me projektin. Projekt i ngjashëm me detyra të ngjashme.	Nr. i projekteve			
Eksperienca në vendet në zhvillim	Vendet			

Mbështetja nga Zyra Qendrore e Konsulentit Drejtues

Kriteret	Emri	
Eksperienca profesionale	Vitet	
Eksperienca rajonale	Vendet	
Eksperienca menaxheriale	Vitet	
Vitet me firmën	Vitet	

Personeli kryesor lokal/rajonal afatgjatë

Kriteret	Emri	NN1	NN2	NN3
	Posti/funksioni			
Arsimi profesional në lidhje me projektin dhe postin	Diploma(t)			
Eksperienca profesionale, nga puna e parë pas arsimit profesional	Vitet			
Eksperienca specifike në lidhje me projektin. Projekt i ngjashëm me detyra të ngjashme.	Nr. i projekteve me > 6 muaj kontribut			
Statusi i punësimit te firma dhe/ose vitet e mbledhura gjatë detyrave afatshkurtra dhe afatgjata për ofertuesin	Vitet			

ANEKSI D
DEKLARATA E SIPËRMARRJES

(emri i projektit)

Palët në procedurën e dhënies theksojnë rëndësinë e procedurës së drejtë, të lirë dhe konkurruese të dhënies që përjashton abuzimin. Në këtë aspekt (emri i konsulentit/shoqatës së konsulencës) në këtë mënyrë nuk ka ofruar apo dhënë ndonjë avantazh të papranueshëm drejtpërdrejt ose jo te punonjësit e shërbimit publik ose persona të tjerë në lidhje me këtë tender, dhe nuk do të ofrojnë ose japin ndonjë shtysë të tillë apo shpërblim në këtë procedurë dhënieje ose, në rastin e një dhënieje, gjatë ekzekutimit pasues të marrëveshjes.

(Emri i konsulentit/shoqatës së konsulencës) do të informojë të punësuarit e tij që detyrat e tyre përkatëse dhe përkushtimi i tyre për të respektuar këtë detyrim të vetëvendosur dhe për të respektuar ligjet (emri i vendit të projektit).

(Vendi dhe data)

(Emri i konsulentit / emri i shoqërive të shoqatës së konsulencës)

(Nënshkrimi/et e përfaqësuesit/ve ligjorë; në rastin e një bashkimi të të gjithë partnerëve)

ANEKSI E
MODEL PËR PROPOZIMIN FINANCIAR – DETAJIMI I KOSTOS

PËRMBLEDHJE	**Shuma (euro)**	
	Berat/Kuçovë (BK)	**Lushnjë(L)**
1. Personeli i huaj		
2. Tarifat për Personelin e huaj		
3. Personeli lokal		
Nen-totali – kostoja e personelit		
4. Transporti lokal		
5. Zyra e projektit		
6. Raportet dhe dokumentet		
Nëntotali logjistik (transporti lokal, zyra e projektit, raportet dhe dokumentet)		
Totali – Kostot fikse		
7. Kostoja e udhëtimeve ndërkombëtare		
8. Kostoja e pajisjeve		
9. Kosto të ndryshme		
Totali – kostoja e rimbursueshme		
Totali i përgjithshëm	≤770 000	≤128 000

1. Personeli i huaj	**Njësia**	**Sasia (BK/L**	**Norma për njësi (euro)**	**Shuma euro**	
				Berat/Kuçova (BK)	**Lushnja (L)**
1.1 Drejtues ekipi	Muaj				
1.2 NN	Muaj				
1.3 …	Muaj				
1.4 …	Muaj				
Nëntotali. Personel i huaj					
2. Honorarët, akomodimi, shpenzimet shtesë të udhëtimit për personelin e huaj					
2.1 Honorarët dhe akomodimi – personeli afatgjatë	Muaj				
2.2 Honorarët dhe akomodimi – personeli afatshkurtër	Muaj				
Nëntotali. Honorari dhe akomodimi					
3. Personeli lokal (duke përfshirë honorarët dhe akomodimin)					
3.1 NN	Muaj				
3.2 …	Muaj				
3.3 …	Muaj				
Nëntotali. Personel lokal					
4. Transporti lokal					
4.1 Marrje me qira e automjeteve ose përdorimi i automjeteve të veta	Muaj				
4.2 Automjetet O&M, duke përfshirë shoferin, siguracionin, riparimet	Muaj				
4.3 Transport tjetër lokal (afatshkurtër, piku)	Ditë				
Nëntotali. Transporti lokal					
5. Zyra e projektit					
5.1 Qiraja e zyrës	Muaj				
5.2 Operimi i zyrës	Muaj				
Nëntotali. Zyra e Projektit					
6. Raporte dhe dokumente					
6.1 (Tipi i raporteve/dokumenteve që paraqiten)	Rep/doc.				
6.2					
6.3					
6…					
Nëntotali. Raporte dhe dokumente					
7. Udhëtimi ndërkombëtar (shuma e plotë)					
7.1 Udhëtime vajtje-ardhje					
7.2 Kosto shtesë për udhëtimet					
7.3 Udhëtime të tjera ndërkombëtare					
Nëntotali fluturime ndërkombëtare – të rimbursueshme					
8. Pajisje (të rimbursueshme)					
8.1					
8.…Pajisje të tjera që duhet të dorëzohen/konsumohen					

Nëntotali. Totali i pajisjeve					
9. Artikuj/shërbime të ndryshme dhe opsionale					
9.1 Programe dhe pjesë fizike për mbajtjen e llogarive/faturimin/MIS/CAD etj. (të rimbursueshme)				≤ 47 500	
9.2 Ture studimore në Shqipëri (shumë e plotë)				≤ 2 000	
9.3 Buxhet për të ndryshme / të paparashikueshme				≤ 103 500	
Nëntotali. Totali i artikujve të ndryshëm/shërbimeve (shumë provizore)				≤ 153 000	≤ 30 000

Vlerësimi i tatimeve

Nëse kërkohet në SCT dhe për qëllime informimi, ofertuesi duhet të vlerësojë tatimet mbi llojet e ndryshme të shërbimeve që janë në fuqi një muaj para datës së paraqitjes.

Tatimet e mundshme për komponentë të ndryshëm	**Shuma (euro)**	**Tatimet (euro)**
1. Personeli i huaj		
2. Honorarët për personelin e huaj		
3. Personeli lokal		
4. Transporti lokal		
5. Zyra e projektit		
6. Raportet dhe dokumentet		
Nëntotali. Tatimet për shpenzimet fikse		
7. Kostoja e udhëtimeve ndërkombëtare		
8. Kostoja e pajisjeve		
9. Kosto të ndryshme		
Nëntotali. Tatimet për shpenzimet e rimbursueshme		
Totali i përgjithshëm i tatimeve		

ANEKSI F
MODELI I GARANCISË SË PARAPAGESËS

Letër nga garantuesi për punëdhënësin

Më ….. (datë) …..ju lidhët me ……(konsulenti) …… një kontratë për ……(projekti, subjektet e kontratës) …… për shumën prej ……. (çmimi i kontratës) euro.

Në pajtim me dispozitat e kontratës, konsulenti merr një parapagim në shumën prej …… (shuma e parapagimit) ……euro të barabartë me ….% të çmimit të kontratës.

Ne të poshtëshënuarit …… (banka) …… duke hequr dorë nga të gjitha kundërshtimet dhe mjetet e mbrojtjes sipas kontratës së sipërshënuar, garantojmë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pavarur të paguajmë, me kërkesën tuaj të parë, çdo shumë të dhënë paraprakisht Konsulentit deri në një total prej …. euro (shuma e parapagimit) (në fjalë: …….) kundrejt deklarimit tuaj me shkrim që konsulenti nuk ka përmbushur sipas parashikimeve Kontratën e sipër-përmendur.

Kjo garanci hyn në fuqi sapo parapagimi t'i jetë kredituar llogarisë së konsulentit.

Kjo garanci zbritet automatikisht në pajtim me kostot përgatitore të paguara dhe shërbimet e dhëna nga konsulenti.

Në rastin e një pretendimi sipas kësaj garancie, pagesa do të bëhet te Kreditanstalt fuer Wiederaufbau, Frankfurt am Main (BIC: KFWDEFF, BLZ 500 204 00), llogaria nr. 38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 3800 0000 00) për shumën prej …… (KfW në emër të punëdhënësit)…..

Kjo garanci skadon jo më vonë se …… (data e rimbursimit)…… datë në të cilën ne duhet të kemi marrë çdo pretendim nëpërmjet letrës me telekomunikim të koduar.

Kuptohet që ju do të ktheni këtë garanci me skadimin e saj ose pas marrjes së shumës totale të pretenduar në bazë të kësaj.

…… ……

Vendi, data Garantuesi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 29.4.2011
Doli nga shtypi më 2.5.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 48 lekë